



European Union  
Election Observation Mission

Final Report

Kosovo 2013



# **ZGJEDHJET KOMUNALE NË KOSOVË\***

**3 NËNTOR DHE 1 DHJETOR 2013**

## **RAPORTI PËRFUNDIMTAR**

**JANAR 2014**

### **MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE**

*Ky raport është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, por vetëm versioni në gjuhën angleze është zyrtar.*

*Ky raport është hartuar nga Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) dhe paraqet gjetjet e MBEVZ-së për Zgjedhjet Komunale të mbajtura me 3 nëntor 2013 dhe 1 dhjetor 2013 në Kosovë. Institucionet e Bashkimit Evropian nuk garantojnë saktësinë e të dhënave të paraqitura në këtë raport, e as nuk e pranojnë përgjegjësinë për ndonjë përdorim të mundshëm të tyre.*

---

\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit dhe me Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

# **Tabela e përmbajtjes**

<b>I. PËRMBLEDHJE</b>	<b>1</b>
<b>II. HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>III. RRETHANAT POLITIKE</b>	<b>3</b>
A. Konteksti politik	3
B. Aktorët kryesorë politikë	4
<b>IV. KORNIZA LIGJORE</b>	<b>4</b>
A. Rregullat e KQZ-së	5
B. Të drejtat zgjedhore	6
C. Sistemi zgjedhor për zgjedhjet komunale	7
D. Pjesëmarrja e grave	7
<b>V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE</b>	<b>8</b>
A. Struktura e administrimit të zgjedhjeve	8
B. Administrimi i zgjedhjeve	8
C. Roli i OSBE-së	9
<b>VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE</b>	<b>10</b>
<b>VII. REGJISTRIMI JASHTË KOSOVËS</b>	<b>10</b>
<b>VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE</b>	<b>11</b>
<b>IX. AMBIENTI I FUSHATËS</b>	<b>11</b>
A. Fushata e rundit të parë	12
B. Fushata e rundit të dytë	13
C. Financimi i fushatës	13
<b>X. KOMPONENTI I MEDIAVE</b>	<b>14</b>
A. Ambienti mediatik	14
B. Korniza ligjore	15
C. Gjetjet e monitorimit të mediave	16
<b>XI. KONTESTET ZGJEDHORE</b>	<b>18</b>
A. Parashtrës dhe ankesat	18
B. Zbatimi i të drejtave zgjedhore	20
<b>XII. KOMUNITETET JO-SHUMICË</b>	<b>21</b>
<b>XIII. VËZHGUESIT VENDORË</b>	<b>22</b>
<b>XIV. VOTIMI DHE NUMËRIMI</b>	<b>22</b>
A. Rundi i parë, 3 nëntor 2013	23
B. Rivotimi në Mitrovicën Veriore, 17 nëntor 2013	23
C. Rundi i dytë, 1 dhjetor 2013	24
<b>XV. SHPALLJA E REZULTATEVE</b>	<b>24</b>
<b>XVI. REKOMANDIMET</b>	<b>26</b>
<b>SHTOJCAT</b>	<b>34</b>
<b>PËRSËRITJA E ZGJEDHJEVE NË MITROVICËN VERIORE, 23 SHKURT 2014</b>	<b>37</b>

## I. PËRMBLEDHJE

Zgjedhjet e vitit 2013 për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale ishin të një rëndësie të veçantë sepse ato ishin zgjedhjet e para që u mbajtën në tërë Kosovën, duke përfshirë edhe katër komunat veriore me shumicë serbe, sipas ligjeve të Kosovës. Ato u mbajtën pas marrëveshjes së 19 prillit 2013 në mes të Prishtinës dhe Beogradit, e lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Mbajtja e zgjedhjeve të Kosovës për herë të parë në veri paraqiste një rën prej sfidave kryesore. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka luajtur një rol kyç në lehtësimin e votimit në veri, si dhe votimit jashtë Kosovës në Serbi dhe Mal të Zi.

Përkundër rrethanave sfiduese në veri dhe pa marrë parasysh të metat, në përgjithësi zgjedhjet janë mbajtur në atmosferë pozitive, dhe kanë qenë një hap i rëndësishëm përpara në zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Njerëzit, duke përfshirë edhe ata në veri, e kanë ushtruar të drejtën e tyre për të votuar. Por kërkohet përmirësim i mëtejshëm në disa fusha, dhe ky raport paraqet edhe rekomandimet e parapara për të ndihmuar në përmirësimin e procesit zgjedhor në të ardhmen.

Në pjesën më të madhe të Kosovës, ambienti zgjedhor ishte i qetë dhe kandidatët ishin në gjendje të zhvillojnë fushatën lirshëm dhe pa pengesë. Fushata ishte dukshëm më aktive para rundit të parë të zgjedhjeve më 3 nëntor, e cila përfshinte edhe tubimet e mëdha, në të cilat shpesh përfshiheshin udhëheqësit e nivelit shtetëror, se sa para rundit të dytë më 1 dhjetor, ku fushata u intensifikua vetëm në javën e fundit para zgjedhjeve. Akuzat se në disa zona ka pasur presion mbi punëtorët e sektorit publik, përfshirë edhe mësimdhënësit, për të marrë pjesë në manifestimet e fushatës, veçanërisht para rundit të parë, u vlerësuan nga EU EOM si të besueshme. Ka pasur akuza të shumta për blerje të votave, me disa indikacione se ishin romët ata që ishin vënë në shënjestër për ketë në disa vende. Para rundit të dytë, pati një tensionim dhe retorikë të fortë politike në disa komuna të cilat ishin në balotazh të ngushtë për kryetar të komunës.

Në shumicën e rasteve, rezultatet zgjedhore nuk u vunë në dyshim publikisht, edhe pse subjektet politike ngritën disa shqetësime, përfshirë edhe ato për numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme, pasaktësitë në listat e votuesve dhe kohën e gjatë që mori numërimi dhe shpallja e rezultateve. Një zhvillim i mirëpritur ishte se shumë kandidatë që kishin humbur garën në zgjedhjet për kryetarë të komunës ua uruan fitoret rivalëve të tyre fitues pas rundit të dytë.

Në katër komunat veriore, frikësimi dhe presioni para rundit të parë nga ata që kundërshtonin zgjedhjet kundër aktivistëve politikë dhe votuesve i kufizuan aktivitetet e fushatës së kandidatëve që merrnin pjesë në garë, duke krijuar një ambient që nuk ishte i përshtatshëm për fushatë të lirë. Në ditën e parë të zgjedhjeve, njerëzit dolën të votojnë në veri, dhe administrimi i zgjedhjeve në përgjithësi ishte bërë pa probleme, përkundër përpjekjeve të kundërshtuesve të zgjedhjeve që t'i bindin njerëzit të mos votojnë. Megjithatë, votimi u ndërpre nga sulmet në tri qendrat e votimit në Mitrovicën Veriore, të cilat çuan në braktisjen e procesit në tërë pjesën veriore. Zgjedhjet në ato qendra të votimit u mbajtën sërish më 17 nëntor, nën masa të rrepta të sigurisë, pa ndonjë incident. Më 17 nëntor, dhe sërish në rundin e dytë më 1 dhjetor në Mitrovicën Veriore, shumë nëpunësve publikë dhe familjeve të tyre iu kërkua që të dalin për të votuar.

Në përgjithësi, korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me normat ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj. Megjithatë janë disa të meta të rëndësishme, përfshirë edhe mangësitë dhe paqartësitë. Përkundër diskutimeve të gjata për reformën zgjedhore, me pak përjashtime, korniza ligjore mbeti e pandryshuar nga zgjedhjet paraprake.

Ligji e përcakton një kuotë minimale prej 30 për qind për të dy gjinitë në listat e subjekteve politike në zgjedhjet për kuvendet komunale dhe për ndarjen eventuale të numrit të vendeve. Megjithatë, në këto zgjedhje në përgjithësi gratë patën një profil të ulët. Prej 224 kandidatëve që konkurruan për kryetarë të komunave, vetëm nëntë ishin gra dhe vetëm njëra prej tyre u zgjodh.

Administrimi i zgjedhjeve është shumë i centralizuar dhe KQZ-ja i merr të gjitha vendimet e rëndësishme duke filluar nga regjistrimi i kandidatëve e deri te emërimi i komisioneve të qendrave të votimit (KVV). Anëtarët e KQZ-së duket se punojnë në mënyrë kolegjinale. Megjithatë, janë vërejtur disa të meta. Ndonëse në përgjithësi e kryen punën e vet në mënyrë transparente, KQZ-ja ka mbajtur dy takime të mbyllura. Pamundësia e KQZ-së për të marrë një vendim të qartë lidhur me pranimin e dokumenteve serbe të identifikimit bëri që disa votuesve tu hiqej e drejta e votimit. Vëzhguesit e MBEVZ raportuan se disa Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ) kritikuan nivelin e mbështetjes teknike që e kishin marrë nga Sekretariati i KQZ-së.

Përgatitjet administrative në pjesë të ndryshme të Kosovës janë bërë në mënyra të ndryshme. Në shumicën e komunave, ato dukej se po vazhdonin pa pengesa të mëdha. Megjithatë, përfshirja e popullatës serbe në veri, si dhe e serbëve të zhvendosur ngriti shumë çështje komplekse dhe politikisht të ndjeshme, siç ishin përgatitja e listave të votuesve, votimi jashtë Kosovës dhe përdorimi i simboleve shtetërore të Kosovës. Përkundër kushteve të vështira në veri, infrastruktura themelore për zgjedhjet ishte përgatitur me sukses. Megjithatë, ndërlikueshmëria dhe ndjeshmëria politike e procesit patën ndikim në transparencën e përgatitjeve të atyre komunave, duke krijuar kështu perceptimin e pasigurisë dhe mungesën e qartësisë. Disa anëtarë të KQZ-së e kritikuan rolin e OSBE-së.

Procesi i votimit jashtë Kosovës nuk u administrua mirë. Regjistrimit i votuesve potencial kosovarë ishte i rëndë dhe për votuesit ai nuk ishte as i lehtë e as përfshirës. Vetëm rreth 14 për qind e personave që fillimisht shprehën interesimin për të marrë pjesë në zgjedhje ja dolën që të votojnë. Më shumë se gjysma e zarfeve me vota përmes postës ishin hedhur poshtë nga KQZ-ja sepse nuk përmbanin kopjet e dokumenteve të vlefshme të identifikimit të votuesve. Fletëpalosja e KQZ-së në gjuhën serbe me informata për votuesit, e cila u ishte dërguar votuesve bashkë me fletëvotimin e zbrazët, i udhëzonte ata që të dërgojnë ose kopjen e një dokumenti të vlefshëm të identifikimit ose një shënim me emrin, mbiemrin dhe të dhënat e tjera personale. Fletëvotimet e atyre që zgjedhën opsionin e dytë më vonë u hodhën poshtë nga KQZ-ja. Kështu që, këtyre votuesve padrejtësisht ju hoq e drejta për të votuar.

Listat e votuesve janë nxjerrë nga regjistrimi qendror civil që mirëmbahet nga Ministria e Punëve të Brendshme. Për zgjedhjet komunale të vitit 2013 ishin të regjistruar rreth 1.8 milionë votues. Në përgjithësi, palët pjesëmarrëse në zgjedhje kishin pak besim në saktësinë e listave të votuesve, veçanërisht për shkak të rasteve të shpeshta të personave që kishin vdekur e të cilët kishin mbetur në regjistrin civil.

Në përgjithësi, mediat iu ofruan subjekteve politike një varg mënyrash të ndryshme për t'i përcjell mesazhet e tyre tek elektorati dhe u ofruan votuesve informata të larmishme për tu mundësuar atyre të bëjnë zgjedhje të informuar. Liria e shprehjes është respektuar. Megjithatë, Komisioni i Pavarur për Media (KPM), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e respektimit të dispozitave ligjore nga mediat, nuk e ka përmbushur përgjegjësinë e vet dhe gjatë tërë periudhës së zgjedhjeve nuk ka mbajtur asnjë seancë zyrtare për të diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Kapaciteti i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i përballur me afate të shkurtra kohore për të vendosur për ankesat dhe me një numër tejet të madh të parashpresave dhe ankesave, ishte i shtrirë në shkallë pothuaj të pamenaxhueshme. Në shqyrtimin e ankesave, Paneli kryesisht kishte qasje formaliste, shpesh pa i hetuar dëshmitë, duke respektuar gjithmonë të drejtën për përdorimin e mjetit juridik efektiv për realizimin e të drejtave zgjedhore.

Votimi dhe numërimi u zhvillua në mënyrë të qetë në tërë Kosovën dhe njerëzit votuan lirisht dhe pa u penguar. MBEVZ e vlerësoi pozitivisht procesin në pothuaj të gjitha vendvotimet e vëzhguara në të dy rundet e zgjedhjeve, edhe pse u vërejtën disa gabime procedurale dhe jo gjithmonë u respektua fshehtësia e votës. Ashtu sikurse rundi i parë që u dëmtua nga incidentet e dhunshme në

Mitrovicën Veriore, në një incident të rëndë me 1 dhjetor në komunën e Parteshit, njerëzit hyn në vendvotime dhe vodhën ose shkatërruan materialet zgjedhore.

Procesi i paraqitjes tabelore të rezultateve ishte i gjatë dhe rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve komunale u certifikuan nga KQZ vetëm më 11 dhjetor. Transparenca e procesit të paraqitjes tabelore të rezultateve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ishte deri diku e kufizuar. Ndonëse vëzhguesit kishin qasje në të gjitha fazat e paraqitjes tabelore të rezultateve, shkalla, kompleksiteti dhe gjatësia e këtij operacioni e vështirësuan përcjelljen e tij, si dhe pati informata të kufizuara lidhur me saktësinë e materialit zgjedhor dhe të rezultateve të paraqitura në tabela. Shumë palë të interesuara, shprehën pakënaqësinë me shpalljen e vonuar të rezultateve të rëndit të parë dhe besim të kufizuar në punën e KQZ-së dhe në transparencën e saj.

## II. HYRJE

Pas ftesës bërë Përfaqësueses së BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe Nënkryetares së Komisionit Evropian, Catherine Ashton, me 4 tetor 2013 u krijua një Mision i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MBEVZ) për të vëzhguar zgjedhjet komunale me 3 nëntor dhe me 1 dhjetor. Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve (MVZ) udhëhiqej nga Shefi i vëzhguesve Roberto Gualtieri, anëtar i Parlamentit Evropian. MBEVZ kishte gjithsej 99 vëzhgues nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra, përfshirë edhe një ekip prej tetë ekspertësh zgjedhor të vendosur në Prishtinë dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në tërë Kosovën. Dy anëtarë të Parlamentit Evropian po ashtu ju bashkuan misionit për rundin e parë të zgjedhjeve me 3 nëntor. Puna e MBEVZ-së mbështetet në Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në Kombet e Bashkuara në tetor 2005.

MBEVZ e vlerësoi tërë procesin zgjedhor në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe me ligjet e Kosovës. Ky raport paraqet gjetjet e MBEVZ-së me rekomandime për të ndihmuar përmirësimin e zgjedhjeve të ardhshme në Kosovë. Edhe pse standardet e zgjedhjeve të përcaktuara nga OSBE dhe nga Këshilli i Evropës formalisht nuk e obligojnë Kosovën, është me rëndësi të theksohet se këto janë standardet që mbizotërojnë në rajon. Meqë Kosova dëshiron të integrohet në këta mekanizma rajonal, MVZ e konsideroi të udhës që edhe rekomandimet e saj t'i bazojë në këto standarde që ekzistojnë në rajon, për të udhëzuar autoritetet e Kosovës në përpjekjet e tyre për të përmirësuar zgjedhjet e ardhshme në pajtim me standardet që zbatohen në fqinjësinë e saj.

MBEVZ dëshiron të shpreh falënderimin e saj për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe për autoritetet e tjera, partitë politike, shoqërinë civile dhe organizatat e mediave për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre gjatë vëzhgimit. MBEVZ po ashtu i është mirënjohës Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë dhe misioneve diplomatike të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian për mbështetjen e tyre gjatë tërë kohës.

## III. RRETHANAT POLITIKE

### A. Konteksti politik

Zgjedhjet komunale të 3 nëntorit 2013 ishin të një rëndësie të veçantë sepse ato ishin zgjedhjet e para që mbaheshin në tërë Kosovën, përfshirë edhe katër komunat veriore me shumicë serbe: Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, sipas ligjeve të Kosovës. Ato pasuan marrëveshjen e 19 prillit 2013 në mes të Prishtinës dhe Beogradit, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, e cila mes tjerash, bënte thirrje për mbajtjen e zgjedhjeve komunale në këto katër komuna me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Kosova e shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 2008. Me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999, ajo ishte vendosur nën administrimin e përkohshëm të OKB-së (UNMIK). Gjatë mandatit të tij, UNMIK-u gradualisht i barti kompetencat tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë. Në vitin 2006, filluan negociatat ndërkombëtare për përcaktimin e statusit të Kosovës. Në muajin shkurt 2007, i dërguari special i OKB-së, Martti Ahtisaari, e paraqiti propozimin e tij për "pavarësi të mbikëqyrur" i cili nuk u pranua nga Beogradi. Sidoqoftë, në përputhje me planin e Ahtisarit, u krijua një Grup Drejtues Ndërkombëtar (ISG) për të mbikëqyrur punën e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (ICR), i cili e kishte për detyrë të mbikëqyrte zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe për të mbështetur përpjekjet e autoriteteve të Kosovës. Me shpalljen e pavarësisë, Kosova u zotua që të zbatojë obligimet e saj sipas planit të Ahtisarit. Në shtator të vitit 2012, ISG formalisht i dha fund mbikëqyrjes dhe Kosova e mori përgjegjësinë për të qeverisur veten.

Në pajtim me planin e Ahtisarit, janë krijuar komuna të reja me shumicë serbe. Megjithatë, katër komunat veriore mbetën jashtë kontrollit të Prishtinës. Negociatat që çuan në Marrëveshjen e 19 prillit 2013 kishin për qëllim të adresojnë ketë dhe të mundësojnë integrimin e komunave veriore në strukturat qeverisëse të Kosovës. Më 27 qershor 2014, Kuvendi i Kosovës e ratifikoi marrëveshjen.

Kushtet për zgjedhje në veri ishin veçanërisht sfiduese. Institucionet e Kosovës nuk kishin ndikim atje dhe KQZ-ja nuk mundte të komunikonte drejtpërdrejt me Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ). Në këto rrethana, Misioni i OSBE-së luajti një rol kyç në lehtësimin e pjesëmarrjes së popullatës serbe të Kosovës duke ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve në katër komunat veriore, si dhe votimit jashtë Kosovës përmes postës. Një fushatë e fuqishme kundër mbajtjes së zgjedhjeve e vështirësoi edhe më shumë ambientin për fushatë zgjedhore në rundin e parë.

## B. Aktorët politikë kryesorë

Këto zgjedhje komunale kishin një rëndësi edhe më të madhe për shumë parti politike sepse ato shiheshin si test vendimtar para zgjedhjeve të ardhshme për Kuvendin e Kosovës. Disa parti i fokusuan përpjekjet e tyre në komuna të caktuara, kështu që interesimi në disa vende ishte shumë i madh dhe konkurrenca në garë ishte veçanërisht e madhe.

Në mesin e garuesve, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), parti në pushtet që e ka numrin më të madh të përfaqësuesve në Kuvendin e Kosovës po i mbronte 14 pozita të kryetarëve të komunave. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), parti më e madhe opozitare në zgjedhjet e fundit për Kuvend të Kosovës në vitin 2010 po i mbronte shtatë, përfshirë edhe kryeqytetin Prishtinë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) po i mbronte gjashtë, kryesisht në pjesën perëndimore. Ajo hyri në zgjedhje komunale në koalicion me Lidhjen Demokratike të Dardanisë (LDD). Vetëvendosja, e cila për herë të parë u përfaqësua në kuvend në vitin 2010, po garonte për herë të parë në zgjedhje komunale. Aleanca Kosova e Re (AKR) nuk e kishte asnjë pozitë të kryetarit të komunës para zgjedhjeve të vitit 2013.

Në komunat me shumicë serbe, si në veri ashtu edhe në jug, kishte garë të fortë në mes të Partisë së Pavarur Liberale (Samostalna Liberalna Stranka - SLS), pjesë e koalicionit qeverisës në Kosovë dhe iniciativës së re të krijuar qytetare 'G.I. Srpska', e cila mbështetej nga disa parti të Beogradit. Në Graçanicë në garë ishte edhe Aleanca e Serbëve të Kosovës (SKS), një iniciativë e re qytetare. Gara në zonat me shumicë serbe ishte veçanërisht e ashpër, pasi që 'G.I. Srpska' e mbështetur nga Beogradi përpiquej të zëvendësonte përfaqësuesit serbë të cilët kishin marrë pjesë në institucionet e Kosovës edhe para Marrëveshjes së 19 prillit 2013.

## IV. KORNIZA LIGJORE

Në përgjithësi, korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në përputhje me normat ndërkombëtare për të cilat është zotuar Kosova në Kushtetutën e saj. Sidoqoftë, ka disa të meta të rëndësishme në aspekte kyçe të legjislacionit zgjedhor, duke përfshirë edhe mangësitë dhe paqartësitë. Në vitin 2011, u themelua një komision i përkohshëm parlamentar me qëllim që të propozonte një reformë të përgjithshme zgjedhore. Megjithatë, procesi i reformës ka ngecur dhe me disa përjashtime, korniza ligjore me të cilën janë qeverisur zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme dhe lokale mbeti në fuqi edhe për zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale në vitin 2013.

Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e ndonjë zotimi ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ose për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, neni 22 i Kushtetutës e thekson zbatimin e drejtpërdrejtë të një numri marrëveshjesh dhe dokumentesh që janë të rëndësishme për zgjedhjet. Këto dokumente përfshijnë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike (KNDKP), Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut



(KEDNJ) dhe Protokollet e saj, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit të Grave. Për më tepër, Neni 53 i Kushtetutës i obligon autoritetet shtetërore të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me ligjet dhe Kushtetutën në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, të drejtat e mishëruara në KEDNJ, si dhe në dokumentet e tjera ligjore ndërkombëtare të cilave u referohet Kushtetuta, janë drejtpërdrejtë të zbatueshme, dhe në rast të konfliktit mes tyre, kanë prioritet ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Tekstet kyçe ligjore që qeverisin zgjedhjet në Kosovë fillojnë me Kushtetutën e 15 qershorit 2008, e cila përcakton parimet dhe të drejtat themelore dhe përcakton strukturat dhe institucionet e pushtetit që janë të rëndësishme për zgjedhjet, siç është KQZ. Ligji për Zgjedhjet Lokale (LZL) i 5 qershorit 2008 përcakton dispozitat kryesore për organizimin e zgjedhjeve komunale. Megjithatë, pjesa më e rëndësishme e legjislacionit është Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i 5 qershorit 2008, shumë dispozita të të cilit aplikohen për zgjedhjet komunale dhe për kryetarë të komunave përmes referencës që i bëhet në ligjin për zgjedhjet lokale. Ai u ndryshua në tetor të vitit 2010 duke futur disa ndryshime, kryesisht lidhur me procedurat për parashtresa dhe ankesa.

Ligjet e tjera dhe aktet nënligjore të rëndësishme për zgjedhjet lokale përfshijnë Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të 20 shkurtit 2008, i cili përcakton statusin e komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme për funksionimin e tyre; Rregulloren e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të 4 shtatorit 2008, e cila përcakton funksionimin e atij organi; Rregullorja e punës së PZAP-së, e cila e zgjeron ligjin në lidhje me shqyrtimin e parashtresave dhe ankesave; Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDK), i ndryshuar në dhjetor 2011 dhe në gusht 2012; Ligjin për Financimin e Partive Politike të 16 shtatorit 2010, i ndryshuar në dhjetor 2011 dhe korrik 2013; dhe Kodin Penal të 22 prillit 2012.

## **A. Rregullat e KQZ-së**

KQZ ka publikuar 17 rregulla për këto zgjedhje të cilat i sqarojnë dispozitat e ligjit dhe japin më shumë hollësi se si të zbatohen ato në praktikë. Ato trajtojnë aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Në të vërtetë, disa aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor nuk përshkruhen në hollësi në LZP dhe kanë mbetur të sqarohen në rregulloret e KQZ-së.

Për shembull, LZP nuk i rregullon qartë aktivitetet e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), përfshirë numërimin, tabelimin dhe certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve; ato adresohen më hollësisht vetëm në Rregullat e KQZ-së Nr. 6 dhe Nr. 9. LZP vetëm i referohet QNR-së në kontekstin se kush mund të vëzhgojë dhe kush mund të ankohet për punën e QNR-së. Procedura e anulimit të rezultateve zgjedhore dhe për përsëritjen e votimit është e paqartë në LZP, dhe është rregulluar vetëm me dy rregullore të KQZ-së (Rregulloret Nr. 9 dhe Nr. 6). Ngjashëm, përgjegjësitë e KQZ-së lidhur me trajnimin e KKZ-ve dhe KVV-ve rregullohen vetëm me rregulla të KQZ-së (Rregullën Nr. 9). Përfshirja e këtyre procedurave në ligj mund të ndihmojë në rritjen e besimit në proces.

Një shembull tjetër i një çështjeje të rëndësishme e cila nuk rregullohet në ligj, por që i është lënë rregullës, është njoftimi për zhvillimet politike. LZP dhe LZL i referohen në përgjithësi të drejtës së subjekteve politike që të mbajnë manifestime të fushatës, të publikojnë dhe shpërndajnë materiale të fushatës, etj. Rregulla e KQZ-së Nr. 13 për Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike shkon përtej kësaj, duke theksuar se ku nuk duhet mbajtur takimet publike, si në institucionet qeveritare, në shkolla gjatë orarit të mësimin, në spitale, objekte fetare, etj., si dhe procedurat dhe afatet kohore për njoftimin e Zyrtarit Komunal të Zgjedhjeve (ZKZ) dhe për

autorizimin e ngjarjes nga ZKZ, duke marrë parasysh rekomandimin e policisë dhe se a ka ndonjë subjekt tjetër që ka planifikuar ndonjë ngjarje në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Edhe pse rregullat e detajuara në Rregullore nuk janë tepër kufizuese, çështjet themelore që prekin të drejtën e mbajtjes së tubimeve politike duhet të përfshihen në ligj e jo të lihen që të rregullohen nga KQZ-ja sa herë që të ketë zgjedhje.

## **B. Të drejtat zgjedhore**

E drejta universale e votës është e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës, ku thuhet se çdo qytetar që ka arritur moshën 18 vjeçare ka të drejtë të votojë, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. LZP i thekson kriteret për të drejtën për të votuar. Formulimi i tij nuk është i qartë. Edhe nëse lexohet në lidhje me legjislacionin tjetër të rëndësishëm, siç është Ligji për Shtetësinë, qëllimi i tij nuk mund të kuptohet lehtë. Duket se synimi i përgjithshëm është që kriteret të jenë përfshirëse, në mënyrë që çdo person i cili mund të ketë të drejtë të jetë shtetas i Kosovës, edhe nëse ai/ajo nuk është i tillë, t'i jepet e drejta për të votuar. Kjo vlen për të gjithë ata votues potencialë që kanë të drejtë në shtetësi por të cilët, për shkak të lëvizjeve të popullsisë në dekadat e fundit, nuk janë shtetas të Kosovës. Sipas LZP-së, një person ka të drejtë të votojë nëse: është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998 (me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës); dhe në fund, nëse e ka fituar statusin e refugjatit, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës.

Lista e votuesve mund të kontestohet në gjykata të shkallës së parë. Sipas LZP-së, kërkesat lidhur me përjashtimin e padrejtë nga ose përfshirjen në lista të votuesve, qoftë në mënyrë të rregullt ose me postë, duhet të pranohen nga gjykata jo më vonë se 40 ditë para Ditës së Zgjedhjeve. Gjatë këtyre zgjedhjeve lokale, afati i shkurtër kohor i lejuar për procesin e publikimit, shqyrtimit, kontestimit, konfirmimit dhe marrjes së vendimit për listën e votuesve, nënkuptonte se nuk ishte respektuar gjithmonë e drejta në mjet efektiv juridik.

Kufizimet e të drejtës për të votuar që i përmbante LZP ishin jo-diskriminuese. Në mesin e tyre janë ato kur një person është shpallur mentalisht i paafte me vendim të prerë të gjykatës, kur është duke e vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal për Ish-Jugosllavinë (ICTY), ose kur është i akuzuar nga ICTY dhe nuk iu ka bindur urdhrin për tu paraqitur para Tribunalit.

Kriteret e të drejtës për të qenë kandidatë për kuvendin komunal ose për kryetar të komunës po ashtu janë përcaktuar me ligj. Kriteret e përgjithshme janë përcaktuar në LZP. Çdo person që e ka emrin në listën e votuesve ka të drejtë të jetë kandidat. LZP e ndalon këtë të drejtë për disa kategori të caktuara të shërbyesve civilë. LZP po ashtu përcakton se kandidatët nuk kanë të drejtë kandidimi nëse janë shpallur fajtorë për veprë penale në tri vitet e fundit, nëse nuk e kanë paguar gjobën e caktuar nga PZAP-ja ose nëse nuk i janë përmbajtur një urdhri të KQZ-së ose PZAP-së. Sa i përket kandidatëve të përfshirë në procedura penale, ligji e mbështet supozimin e pafajësisë deri në shpalljen fajtor nga ndonjë gjykatë e ligjshme. Një numër kandidatësh për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale ishin të akuzuar, madje edhe për krime lufte. Një kandidat për pozitën e kryetarit të komunës së Skenderajt është zgjedhur derisa ishte në paraburgim.

LZL përcakton kriteret specifike për të qenë kandidat në zgjedhjet lokale. Për zgjedhjet për kuvendet komunale, çdo subjekt politik do të paraqes listën e kandidatëve për regjistrim për secilën komunë ku garon. Për zgjedhjet për kryetar të komunës, përveç kriterëve të përgjithshme për të fituar të drejtën, një kandidat për kryetar duhet të ketë qenë banor i komunës në të cilin ai apo ajo është duke kandiduar për së paku tri vite. Kryetarët e zgjedhur të komunës dhe anëtarët e kuvendeve komunale nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë organi tjetër të zgjedhur me votë, si Kuvendi i Kosovës ose ndonjë kuvend tjetër komunal.

### C. Sistemi zgjedhor për zgjedhjet komunale

Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes në Kosovë. Për këtë qëllim, secila komunë konsiderohet si një zonë e vetme zgjedhore. Kuvendi komunal është organi më i lartë i Komunës dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga votuesit e regjistruar në komunë. Subjektet e regjistruara politike paraqiten në fletëvotimet 'me lista të hapura' për secilën komunë në të cilën garojnë në zgjedhje. Secili votues duhet të votojë një subjekt të certifikuar politik dhe e ka opsionin për të votuar për një kandidat nga lista e kandidatëve të atij subjekti politik. Nëse në fletëvotim është shënuar më shumë se një kandidat, do të numërohet vetëm vota për subjektin politik. Në këtë rast, vota e dhënë për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të atij subjekti politik. Shpërndarja e vendeve në secilin kuvend komunal bëhet në pajtim me metodën Sainte-Lague. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të kuvendit komunal është katër vjet. Numri i anëtarëve në kuvendin komunal varet nga numri i qytetarëve në atë komunë.

Kryetari i komunës zgjidhet për mandat katërvjeçar. Secili kryetar zgjidhet nëse ai/ajo fiton më shumë se 50%, plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë. Nëse asnjë kandidat nuk e arrin këtë përqindje, katër javë pas rundit të parë, organizohet rundi i dytë i zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme në rundingun e parë.

### D. Pjesëmarrja e grave

Korniza ligjore e Kosovës synon që të sigurojë barazinë gjinore si në Kushtetutë ashtu edhe në legjislacionin zgjedhor. Kushtetuta thekson se përbërja e Kuvendit të Kosovës, si dhe e shërbimit civil dhe e gjyqësorit, duhet të respektojë parimet e njohura ndërkombëtarisht për barazinë gjinore. Për kuvendet komunale, LZP-ja dhe LZL-ja përcaktojnë një kuotë minimale prej 30 për qind për të dy gjinitë për secilën listë të subjekteve politike. Prej 7,926 kandidatëve që ishin certifikuar, 33 për qind e tyre ishin gra. Për të garantuar edhe më mirë përfaqësimin e grave, nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30 për qind nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirënditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30 për qind. Ky diskriminim i dyfishtë pozitiv është kritikuar nga disa bashkëbisedues të MBEVZ-së. Duke marrë parasysh sistemin e Kosovës me lista të hapura, në të cilin votuesit mund të zgjedhin kandidatin në listë, fakti se kuota prej 30 për qind aplikohet edhe në rezultatin e zgjedhjeve ka nënkuptuar se në disa raste grave u janë ndarë ulëse edhe pse kishin fituar shumë më pak vota se kandidatët meshkuj në të njëjtën listë të cilëve nuk u janë ndarë ulëse. Kjo nuk është në pajtim me vullnetin e votuesve ose me parimin e barazisë së votës. Edhe pse kjo masë mund të arsyetohet se është masë kalimtare për të promovuar pjesëmarrjen e grave, për një periudhë afatgjate duhet të merret parasysh ose kthimi në sistemin me lista të mbyllura, në të cilin votuesit nuk i zgjedhin kandidatët individualë ose, nëse mbahen listat e hapura, që aplikimi i kuotës gjinore të bëhet vetëm për renditjen e kandidatëve në listë e jo edhe për rezultat.

Masat e dizajnuara për të promovuar barazinë gjinore kanë pasur vetëm një efekt të kufizuar në praktikë. Në përgjithësi, gratë kanë luajtur rol të profilit të ulët gjatë zgjedhjeve. Nga 224 kandidatë që kanë garuar për kryetarë të komunave, vetëm nëntë kanë qenë femra dhe vetëm njëra prej tyre është zgjedhur, ajo në Gjakovë. Kuotat nuk janë paraparë për organet për menaxhimin e zgjedhjeve. Si rezultat, gratë ishin të nën-përfaqësuara në KQZ, në të cilin kryesuesja është e vetmja anëtare (femër), si dhe në KKZ dhe KKV.

## V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

### A. Struktura e administrimit të zgjedhjeve

Zgjedhjet komunale u administruan nga një administratë zgjedhore me tri nivele e përbërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që është organ i përhershëm, si dhe 38 Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe 2,366 Komisione të Vendvotimeve (KVV) të emëruara vetëm për këto zgjedhje.

KQZ përbëhet nga kryesuesja dhe dhjetë anëtarë të emëruar nga Presidentja e Kosovës. Kryesuesja është zgjedhur për mandat shtatëvjeçar nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Dhjetë anëtarët janë emëruar pas propozimeve të gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të Kuvendit të Kosovës, dhe katër anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë. Përderisa mandati i anëtarëve të KQZ-së nuk është rregulluar me ligj, në praktikë ata emërohen pas zgjedhjeve të përgjithshme (çdo katër vjet). Kryesuesi mund të shërbej për jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme dhe anëtarët e KQZ-së për jo më shumë se tri mandate të njëpasnjëshme.

KKZ-të u emëruan pas shpalljes së zgjedhjeve dhe sipas ligjit, mandati i tyre skadon 15 ditë pas certifikimit të rezultateve. KKZ-të përbëhen nga kryesuesi i cili është zyrtar ekzekutiv i punësuar nga KQZ (Zyrtari Komunal i Zgjedhjeve) dhe 6-10 anëtarë që përfaqësojnë partitë më të mëdha politike në Kuvendin e Kosovës si dhe subjektet politike të përfaqësuara në nivelin lokal. Nga gjithsej 293 anëtarë të KKZ-ve, 35 ishin gra (12 për qind). Përqindja më e madhe e grave ishte në KKZ-në e Mitrovicës Veriore – shtatë nga 10 anëtarët.

2,366 vendvotimet gjendeshin në 798 qendra të votimit. Në përgjithësi, përbërja e secilës KVV pasqyronte përbërjen e KKZ-së përkatëse. Përveç anëtarëve “të rregullt” të KVV-së, në secilën komunë kishte edhe një rezervë shtesë të zyrtarëve të KVV-së, e cila ishte përgjegjëse për të organizuar votimin për votuesit me nevoja të veçanta (votimi në spitale, votimi në shtëpi, etj) dhe të cilët ishin në dispozicion për të zëvendësuar anëtarët e rregullt të KVV-vë në rast nevojë. Pas rundit të parë të zgjedhjeve, pati ndryshime në përbërjen e KVV-ve në të gjitha komunat që shkuan në balotazh. Anëtarët e KVV-ve u zëvendësuan ose për shkak të punës së dobët në rundin e parë ose sepse partitë që i kishin propozuar ata nuk ishin të interesuara për balotazh. Megjithatë, këta anëtarë të ri nuk ishin emëruar formalisht nga KQZ-ja, siç kërkohet me ligj.

### B. Administrimi i zgjedhjeve

Administrimi i zgjedhjeve komunale në Kosovë ishte shumë i centralizuar ku KQZ merrte të gjitha vendimet e rëndësishme që nga certifikimi i kandidatëve deri të emërimi i KVV-ve. Si rezultat, KKZ-ve nuk u ishin dhënë aq shumë autorizime. Duke pasur parasysh situatën e veçantë në katër komunat veriore, përgatitjet administrative për zgjedhje ishin të ndryshme në pjesë të ndryshme të Kosovës. Në shumicën e komunave, përgatitjet teknike u dukën se kishin shkuar pa pengesa të mëdha. Megjithatë, përfshirja e popullatës serbe në veri si dhe e serbëve të zhvendosur ngriti shumë çështje komplekse dhe politikisht të ndjeshme, siç janë përgatitjet e listave të votuesve, votimi jashtë Kosovës dhe përdorimi i simboleve shtetërore të Kosovës.

Në përgjithësi, zyrtarët zgjedhorë në nivelin qendror dhe komunal dukej se i bënë përgatitjet administrative në mënyrë profesionale dhe transparente. Përkundër akuzave të shpeshta se KQZ-ja ishte organ shumë i politizuar, anëtarët e KQZ-së dukej se punonin në mënyrë kolegiale gjatë punës së MBEVZ-së, duke marrë shpesh vendimet unanimisht dhe pa qasje partiake.

Megjithatë, janë vërejtur edhe disa të meta në punën e Komisionit. Edhe pse me ligj kërkohet që takimet e KQZ-së të jenë të hapura për publikun, KQZ mbajti dy takime të mbyllura pas rundit të dytë, në të cilat nuk u ftuan mediat dhe vëzhguesit. KQZ-ja po ashtu u kritikua shumë për paaftësinë e saj për të marrë vendim të qartë lidhur me pranimin e dokumenteve të identifikimit të

Serbisë për identifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve, gjë që çoi në një konfuzion dhe që ua hoqi disa votuesve të drejtën e votës. Pranimi i këtyre dokumenteve ishte parashikuar në konkluzionet e marrëveshjes së Brukselit. Për më tepër, programi i votimit jashtë Kosovës i organizuar nga KQZ-ja me mbështetjen e OSBE-së nuk u administrua mirë, duke ua hequr po ashtu të drejtën e votimit shumë votuesve (shih më poshtë). Në fund, vëzhguesit e MBEVZ-së raportuan se disa KKZ e kritikuan nivelin e mbështetjes që kishin marrë nga Sekretariati i KQZ-së.

KQZ nuk ja doli të respektoi disa afate operacionale dhe ligjore, kryesisht lidhur me paraqitjen publike dhe certifikimin e listave të votuesve. Përdorimi i simboleve shtetërore në materialet zgjedhore ishte kontestuese. Derisa KQZ-ja arriti një marrëveshje për të hequr simbolin nga fletëvotimet, ai mbeti në listat e votuesve, në formularët e rezultateve dhe në dokumentacionin tjetër zyrtar të zgjedhjeve. Kjo krijoi një pasiguri pak para rundit të parë të zgjedhjeve, në atë se a do të pranohen këto dokumente në komunat veriore.

KKZ-të punonin në mënyra të ndryshme. Disa mbanin takime të shpeshta zyrtare përderisa të tjerat takoheshin jozyrtarisht dhe pa procesverbale. Në pjesën më të madhe, KKZ-të ishin operacionale dhe gëzonin besimin e palëve kryesore të përfshira në zgjedhje. Pas rundit të parë të zgjedhjeve, KKZ-të mbajtën seanca trajnimi në tërë Kosovën, kryesisht për të adresuar dobësitë procedurale që u panë me 3 nëntor. Megjithatë, në disa zona anëtarët e ri të komisioneve nuk ishin trajnuar në mënyrë adekuate.

KQZ-ja e bëri një fushatë për edukimin e votuesve para të dy rundeve të zgjedhjeve, kryesisht me spotet televizive 'dil-dhe-voto'. Megjithatë, fushata për tua sqaruar votuesve se si duhet të votojnë – si duhet plotësuar fletëvotimet e ndërlikuara për zgjedhjet për kuvende komunale (votimi preferencial) – ishte e pamjaftueshme, siç u dëshmuua nga numri i madh i votave të pavlefshme (shih më poshtë).

### **C. Roli i OSBE-së**

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK) kishte një rol kyç në organizimin e zgjedhjeve përmes lehtësimit të pjesëmarrjes së popullatës serbe që banon në komunat veriore dhe jashtë Kosovës (kryesisht në Serbi). Në ditën e zgjedhjeve në rundin e parë, OSBE vendosi personelin e saj në secilin vendvotim në veri, për të ndihmuar në mbajtjen e zgjedhjeve. Fillimisht, autoriteti dhe përgjegjësia e OMIK-ut për aspekte të ndryshme të procesin zgjedhor nuk ishte rregulluar me asnjë marrëveshje formale. Çështja në fund u rregullua me shkëmbimin e letrave ndërmjet kryesueses së KQZ-së dhe shefit të OMIK-ut në fillim të tetorit.

Kushtet për mbajtjen e zgjedhjeve në veri ishin veçanërisht sfiduese. Institucionet e Kosovës nuk kishin ndikim atje, dhe KQZ-ja nuk mundte të komunikonte drejtpërdrejt me KKZ-të. Prandaj, OMIK-u lehtësoi kontaktet ndërmjet zyrtarëve zgjedhorë, ndihmoi në përgatitjen e listave të votuesve dhe në trajnimin e stafit të zgjedhjeve.

Përkundër shumë sfidave, infrastruktura themelore për zgjedhjet, siç është përgatitja e listave të votuesve dhe krijimi i vendvotimeve ishin realizuar me sukses në veri. Megjithatë, kompleksiteti dhe ndjeshmëria politike e procesit ndikoi në transparencën e përgatitjeve për zgjedhje në këto komuna, duke krijuar perceptimin e pasigurisë dhe mungesës së qartësisë. Disa anëtarë të KQZ-së e kritikuan rolin e OSBE-së për shkak të mungesës të informacionit rreth përgatitjeve në veri, si dhe për votimin jashtë Kosovës, të shkaktuar nga mungesa e një mekanizmi formal të raportimit. Pas kërkesës me shkrim nga KQZ-ja, më 31 tetor OMIK-u paraqiti një raport për ndihmën e tij për zgjedhjet.

## VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Kosova ka një sistem pasiv të regjistrimit të votuesve. Listat e votuesve nxirren nga regjistri civil qendror që mirëmbahet nga Ministria e Brendshme. Përveç kësaj, KQZ-ja i shton edhe listat e votuesve të regjistruar për votim jashtë Kosovës. Ndonëse KQZ-ja është përgjegjëse për saktësinë e listave të votuesve, ajo ka vetëm mundësi të kufizuara për të përmirësuar cilësinë e tyre duke marrë parasysh se të gjitha gabimet në bazën e të dhënave të regjistrimit civil përsëriten në mënyrë automatike në listat e votuesve. Një mënyrë e mundshme për adresimin e gabimeve është procesi i verifikimit publik. Megjithatë, për shkak të vonesës në përgatitjen e listave të votuesve në veri, KQZ-ja e vonoi miratimin zyrtar të listave të votuesve, kështu që dështoi të respektojë afatin kohor për procesin e verifikimit publik. Sidoqoftë, votuesit patën mundësi të verifikojnë të dhënat dhe të konfirmojnë se ku ndodhet vendvotimi i tyre përmes internetit. Mbi 140,000 persona e shfrytëzuan këtë mundësi.

Për zgjedhjet komunale të vitit 2013 ishin të regjistruar 1,779,357 votues, një rritje prej 191,103 (11 për qind) krahasuar me zgjedhjet e kaluara. Përveç kësaj, ishin regjistruar edhe rreth 12,000 votues për të votuar jashtë Kosovës.

Në përgjithësi, palët e përfshira në zgjedhje kishin pak besim në saktësinë e listave të votuesve, veçanërisht për shkak të rasteve të shpeshta të personave të vdekur. Të dhënat aktuale të regjistrimit civil bazohen në regjistrimin civil të bërë nga UNMIK-u, pasi që librat e vjetër të regjistrimit ishin marrë nga Serbia pas konfliktit (ato janë duke u kthyer).

Regjistri civil mbahet nga Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Brendshme, e cila ka zyre në të gjitha komunat. Këto zyra regjistrojnë të gjitha ndryshimet e statusit civil të qytetarëve, lëshojnë dokumente të identifikimit, regjistrojnë vendbanimin, etj. Agjencia e pranon se regjistri përmban një numër të panjohur të personave që kanë vdekur ndërmjet vitit 2000 dhe 2012. Prej shkurtit 2013, sistemi është avancuar dhe tani zyrat nëpër komuna janë të lidhura përmes internetit me bazën qendrore të të dhënave dhe personat që vdesin në mënyrë automatike hiqen nga regjistri sapo të lëshohet certifikata e vdekjes. Agjencia për momentin është duke bërë disa përpjekje të verifikojë të dhënat që futen në regjistrin civil me certifikatat e vdekjes të lëshuara që nga viti 2000.

Shumë palë të përfshira në zgjedhje e kritikuan saktësinë e të dhënave të regjistrimit të votuesve si jo reale duke treguar faktin se regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 konstatoi se numri i përgjithshëm i popullsisë është vetëm 1,733,872 (pa komunat veriore), duke përfshirë edhe fëmijët. Megjithatë, regjistrimi nuk e ka përfshirë një numër të konsiderueshëm të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit e të cilët janë në regjistrin civil dhe të cilët sipas ligjit kanë të drejtë për të votuar në të gjitha zgjedhjet e Kosovës, përfshirë edhe ato komunale.

## VII. VOTIMI JASHTË KOSOVËS

Personat me të drejtë vote që përkohësisht jetojnë jashtë Kosovës, ose që janë të zhvendosur nga Kosova kishin të drejtë të regjistrohen dhe të votojnë përmes postës. Pas marrëveshjes së Brukselit, shumë serbë të zhvendosur për herë të parë shprehën interesimin e tyre për të votuar në zgjedhjet e Kosovës. Programi i votimit jashtë Kosovës u administrua drejtpërdrejt nga KQZ-ja, me një rol lehtësues të OMIK-ut.

Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës u bë prej 27 korrikut deri më 17 shtator. Sekretariati i KQZ-së i dërgoi formularët e regjistrimit dhe materialet me informacione për votuesit në 25 shtete. KQZ pranoi 41,168 aplikacione për regjistrim për të votuar me postë, shumica dërrmuese e tyre (mbi 39,000) nga Serbia dhe Mali i Zi. Megjithatë, vetëm 8,383 aplikues u aprovuan nga KQZ-ja si votues. Sipas KQZ-së, pjesa tjetër u refuzuan për shkak të paraqitjes së provave të pamjaftueshme

për të dëshmuar se këta aplikues kishin qenë banorë të Kosovës para 1 janarit 1998. Gjithsejtë 16,355 aplikues të refuzuar paraqitën ankesë në PZAP. Nën presion të madh kohor, paneli dhjetë-anëtarësh i PZAP-së ja doli të shqyrtojë këto ankesa për më pak se dy javë dhe vendosi të lejojë edhe 5,458 të tjerë. Më pastaj, mbi 5,000 aplikues të refuzuar parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme. Megjithatë, shqyrtimi i ankesave u shty deri sa aplikuesit të bënin pagesën e kërkuar prej 30 eurosh. Si rezultat, asnjë prej këtyre ankesave nuk u shqyrtua nga Gjykata para ditës së zgjedhjeve.

Në përgjithësi, procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës ishte i rëndë dhe për votuesit nuk ishte as i lehtë e as përfshirës. Aplikuesit duhej të dëshmonin të drejtën e tyre duke paraqitur kopje të letërnjoftimeve të vjetra të lëshuara në Kosovë, pasaportave, patentë-shoferëve, faturave të shërbimeve komunale, etj. Megjithatë, kjo ishte e vështirë për shumë aplikues pas më shumë se 15 viteve. Së dyti, periudha kohore për regjistrimin jashtë Kosovës ishte jashtëzakonisht e shkurtër duke marrë parasysh se të gjitha aplikacionet, vendimet dhe ankesat duhet të barteshin nga OMIK-u në dhe nga Serbia, dhe tu dërgoheshin votuesve përmes postës së Serbisë. Për më tepër, MBEVZ pranoi informata të besueshme se verifikimi i aplikacioneve nga KQZ-ja nuk ishte gjithmonë konsekuent dhe i bazuar në kriteret objektive, dhe se herë pas here korrespondenca e votuesve dërgohej në adresa të pasakta.

Një problem tjetër kishte të bënte me pranimin e fletëvotimeve nga KQZ-ja përmes postës. Para rundit të parë, KQZ-ja pranoi 11,700 zarfe me fletëvotime, shumica dërmuese e të cilave nga Serbia. Staf i KQZ-së i verifikoi këto zarfe pa i ftuar vëzhguesit që të jenë të pranishëm, para se t'i përcillnin ato në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). KQZ-ja i aprovoi vetëm 5,600 zarfe dhe i refuzoi 6,000 për shkak se nuk e kishin një kopje të një dokumenti të vlefshëm të identifikimit të votuesit, siç kërkohej me rregullën e KQZ-së. Megjithatë, MBEVZ konstatoi se fletëpalosja e KQZ-së në gjuhën serbe me informata për votuesit, e cila u ishte dërguar votuesve bashkë me fletëvotimet e zbrazëta, përmbante informacione çorientuese. Votuesit ishin udhëzuar që bashkë me fletëvotimet e tyre të dërgonin ose një kopje të një dokumenti të identifikimit të tyre ose një shënim me emrin dhe të dhënat e tjera personale të tyre. Ata që ishin përcaktuar të bashkëngjitnin një shënim në vend të kopjes së dokumentit të identifikimit më vonë u refuzuan nga KQZ-ja. Prandaj, këtyre votuesve padrejtësisht iu hoq e drejta për të votuar. Për balotazh, rreth 2,600 vota nga rreth 4,600 sa ishin pranuar nga KQZ-ja përmes postës, u refuzuan.

Në përgjithësi, zbatimi teknik i procesit të votimit jashtë Kosovës ishte i pasuksesshëm. Vetëm rreth 14 për qind e personave që fillimisht kishin shprehur interesimin për tu regjistruar për të votuar përmes postës jashtë Kosovës votuan me sukses në zgjedhjet e 3 nëntorit.

## VIII. CERTIFIKIMI I KANDIDATËVE

Certifikimi i kandidatëve u bë në mënyrë përfshirëse. Deri në afatin ligjor të 4 shtatorit, KQZ-ja certifikoi 103 subjekte politike (parti politike, koalicionet, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur) për të garuar në zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale. Asnjë aplikacion nuk u refuzua – aplikuan 105 subjekte politike por më vonë dy prej tyre u tërhoqën (një iniciativë qytetare dhe një kandidat i pavarur). Me 19 shtator, KQZ-ja organizoi lotarinë për të vendosur për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime.

U certifikuan gjithsejtë 7,926 kandidatë për të garuar për 38 kuvendet komunale, një e treta e tyre femra. Nga 224 kandidatë për kryetarë të komunave, vetëm nëntë ishin femra. Disa kandidatë për kryetarë të komunave në kohën e zgjedhjeve ishin të akuzuar për krime të rënda, disa prej tyre për krime lufte.

## IX. AMBIENTI I FUSHATËS

Në pjesën më të madhe të Kosovës, me përjashtim të theksuar të katër komunave veriore para rundit të parë, fushata zgjedhore në të dy rundet u zhvillua në atmosferë të qetë, dhe kandidatët ishin në gjendje të zhvillonin fushatën lirisht dhe të përcillnin mesazhet të votuesit e tyre pa u penguar. Përveç bërjes së fushatës përmes mediave, subjektet politike mbajtën tubime dhe takime të vogla, si dhe i vunë një theks të fuqishëm kontakteve të drejtpërdrejta me votuesit përmes mbledhjes së votave derë më derë dhe shpërndarjes së fletushkave dhe materialeve të tjera të fushatës dhe përmes përdorimit të posterëve. Garuesit po ashtu përdoren mediat sociale për të reklamuar ngjarjet e fushatës si dhe për reklama me pagesë.

## A. Fushata e rundit të parë

Periudha zyrtare e fushatës zgjedhore për rundin e parë të zgjedhjeve filloi me 3 tetor. Në komunat me shumicë shqiptare, subjektet që u panë më së shumti të bëjnë fushatë ishin partitë më të mëdha në Kuvendin e Kosovës, gjegjësisht PDK që e ka qeverinë dhe LDK-ja opozitare. AAK ishte veçanërisht aktive në përfundim të Kosovës, përderisa Vetëvendosje dhe AKR ishin fokusuar më shumë në zgjedhjet në komuna të caktuara. Ndonëse, këto ishin zgjedhje lokale, udhëheqësit politikë nacional ishin shumë të angazhuar në fushatë, si në tubime ashtu edhe në takime më joformale me votuesit, të cilat u mbuluan gjegjësisht nga mediat. Kandidatët për kryetarë të komunave u vërejtën më shumë se sa kandidatët për kuvendet komunale. Madje, çështjet nacionale u paraqitën fuqishëm, shpesh duke i lënë në hije çështjet lokale. Premtimet e Kryeministrit gjatë fushatës për fonde të konsiderueshme për komunat u kritikuan shumë nga kandidatët e tjerë.

Në tri nga katër komunat veriore, mbizotërimi i madh i frikësimit dhe presionin kundër aktivistëve politikë dhe votuesve i kufizoi aktivitetet e fushatës së kandidatëve në zgjedhje, duke krijuar një ambient që nuk ishte i përshtatshëm për fushatë të lirë. MBEVZ i përcolli rastet e presionit mbi disa individë për mospjesëmarrje në fushatë, dhe i vlerësoi ato si të besueshme. Prandaj zhvillimi i fushatës zgjedhore nga subjektet politike ishte shumë i kufizuar, përderisa fushata kundër pjesëmarrjes në zgjedhje u vërejt shumë më tepër. Ata pak posterë të vendosur të fushatës u shqyen shumë shpejt. Megjithatë, ambienti në Leposaviq ishte më pozitiv dhe garuesit në zgjedhje ishin në gjendje të zhvillonin fushatën më normalisht. Vizitat nga zyrtarët e Beogradit në komunat me shumicë serbe, përfshirë edhe ato në jug, ngjallën kundërtënie, pasi që dukej qartë se ishin në mbështetje të 'G.I. Srpska'.

Dy mjete shpërthyes, me 14 dhe 18 tetor, kishin në shënjestër figurat e SLS-së në Mitrovicën Veriore. Të dy këto figura kishin kërkuar paraprakisht të tërhiqen nga lista e kandidatëve të SLS-së, edhe pse njëri nuk e kishte bërë këtë para afatit për tërheqje. Një mjet i tretë shpërthyes gjatë natës së 18-19 tetorit kishte në shënjestër kandidatin e 'G.I. Srpska'. Në natën e 1 nëntorit, kandidati i 'G.I. Srpska' për kryetar të komunës u sulmua fizikisht.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e përmban edhe Kodin e Mirësjelljes gjatë fushatës, të cilin duhet ta respektonin të gjithë garuesit në zgjedhje dhe shkeljet e të cilit duhet të ndëshkoheshin nga PZAP. Mes tjerash, Kodi e ndalon çdo lloj frikësimi ose dhune nga subjektet politike, si dhe blerjen e votës. Pavarësisht këtyre ndalesave, në disa zona janë ngritur akuza për presion ndaj punëtorëve të sektorit publik, përfshirë edhe punëtorët shëndetësorë dhe mësimdhënësit, si dhe studentët dhe nxënësit për të marrë pjesë në manifestimet e fushatës për partinë e cila e kishte pushtetin në atë komunë. MBEVZ-ja i vlerësoi rastet në komunat e Prishtinës, Skenderajt, Lipjanit, Gjakovës, Graçanicës, Klllokotit dhe Leposaviqit si të besueshme. Kishte akuza edhe për largime nga puna të punëtorëve të sektorit publik të motivuara politikisht të cilët u ishin bashkuar subjekteve politike që ishin në opozitë në atë komunë. MBEVZ e konfirmoi këtë praktikë në Malishevë.



MBEVZ pranoi akuza për blerje të madhe të votave, veçanërisht një ditë para ditës së zgjedhjeve. Kishte disa indikacione se romët ishin vënë në shënjestër të blerjes së votave në Mitrovicën Jugore dhe në Graçanicë. Në fund të nëntorit, në një gjykim në Gjykatën Themelore të Gjilanit, një person e pranoi se kishte dhënë laminat dhe një tjetër e pranoi se e kishte marrë atë në këmbim të dhënies së votës së tij për SLS-në në Ranillug më 3 nëntor. Atyre ju shqiptua dënimi më i ulët i mundshëm, meqë e pranuan veprën.

Vendosja e posterëve të fushatës shpesh ishte kundërtënëse. Në disa komuna, subjektet politike theksonin se partitë që e kishin pushtetin në nivel lokal ishin të favorizuara në ndarjen e billbordeve komerciale. Ligji nuk e cakton ndonjë vend publik specifik për postera, por Kodi i Mirësjelljes e ndalon vendosjen e posterëve në vende të caktuara, si në institucione publike, në shenjat e trafikut, etj., si dhe heqjen apo dëmtimin e posterëve. Një numër i madh ankesash janë paraqitur në PZAP për shkeljen e rregullave dhe në shumë raste janë vënë gjoba.

## **B. Fushata e rëndit të dytë**

Ambienti politik në pjesën më të madhe të Kosovës pas rëndit të parë të zgjedhjeve më 3 nëntor ishte i qetë, me disa tensione dhe retorikë të fuqishme politike të shënuar në një numër të vogël komunash në të cilat gara e balotazhit ishte e ngushtë, përfshirë komunën e Pejës, Prishtinës dhe Gjakovës. Në shumicën e rasteve, rezultatet e para për kryetar të komunës nuk u kontestuan publikisht, edhe pse subjektet politike ngritën një varg shqetësimesh, përfshirë edhe ato për numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme dhe pasaktësitë në listat e votuesve, si dhe për kohën e gjatë që mori numërimi dhe shpallja e rezultateve.

Për dallim nga rëndi i parë, ligji nuk e specifikon kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore për rëndin e dytë. Në përputhje me Rregullat Zgjedhore të KQZ-së, më 20 nëntor KQZ-ja e shpalli se fushata zyrtare për rëndin e dytë do të jetë prej 25 deri më 29 nëntor. Nuk ka ndonjë ndalesë ligjore që subjektet politike të bëjnë fushatë edhe para periudhës zyrtare të fushatës. Sidoqoftë, para kësaj kohe fushata kishte rënë në intensitet, duke përfshirë fushatën derë më derë dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me votuesit. Sikurse në rëndin e parë, garuesit përdorën në masë të madhe mediat sociale, por para rëndit të dytë në disa komuna u vërejt më shumë retorika e fuqishme politike.

Gjatë tri javëve pas rëndit të parë, shumica e subjekteve politike ishin më të fokusuar në negociimin e aleancave për garën e balotazhit se sa në fushatën si të tillë (proces që u ndërlikua nga fakti se rezultatet për zgjedhjet për kuvendet komunale, e me këtë edhe forca përkatëse lokale e subjekteve politike nuk dihej akoma). Në përgjithësi, këto aleanca u bënë në nivelin lokal, sipas preferencave të degëve të subjekteve politike. Në javën e fundit para ditës së zgjedhjeve, fushata fitoi disi në intensitet, në disa vende përfshinin edhe tubime të mëdha.

Në komunat veriore me shumicë serbe, për dallim nga periudha e fushatës për rëndin e parë, nuk u vërejt fushatë kundër zgjedhjeve. Megjithatë, u shënuan tensione në disa komuna me shumicë serbe, si në jug ashtu edhe në veri, përfshirë edhe akuza për presion mbi votuesit dhe mbi punëtorët e sektorit publik, veçanërisht, por jo vetëm, nga 'G.I. Srpska'. Në disa raste, në Shtërpce dhe Partesh, vëzhguesit konstatuan se akuzat ishin të besueshme. Pak para rëndit të dytë, tre anëtarë të 'G.I. Srpska' në Shtërpce u morën në pyetje nga policia për akuzat se kishin bërë presion mbi votuesit. Kishte edhe incidente të vogla të dhunshme në Shtërpce. Sikurse para rëndit të parë, MBEVZ-ja pranoi akuza të shumta për blerje votash. Në Partesh, një aktivist i 'G.I. Srpska' u akuzua me pretendimin se u kishte ofruar para votuesve.

## **C. Financimi i fushatës**

Rregullat për financimin e fushatave të subjekteve politike përcaktohen në Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme si dhe në Ligjin për Financimin e Partive Politike të shtatorit 2010 (i cili përndryshe merret me financimin e rregullt të partive politike), i ndryshuar në dhjetor 2011 dhe në korrik 2013, si dhe me rregullat e KQZ-së.

Partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës marrin fonde nga buxheti i Kosovës për aktivitetet e tyre të rregullta, bazuar në ndarjen e vendeve në Kuvend. Ligji për Financimin e Partive politike parasheh mundësinë që Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, të ndajë fonde nga buxheti për financimin e fushatave zgjedhore. Nga këto, për zgjedhjet komunale mund të ndahen 90 për qind në bazë të numrit të vendeve në kuvendet komunale dhe një 10 për qindësh tjetër për partitë e tjera politike të certifikuara për zgjedhje nga KQZ-ja. Megjithatë, një financim i tillë për fushata nuk u nda nga shteti për këto zgjedhje komunale.

Në pajtim me LZP-në, pas shpalljes së zgjedhjeve komunale, KQZ-ja në korrik 2013 lëshoi një vendim për përcaktimin e kufijve të shpenzimeve për secilin subjekt politik gjatë fushatës zgjedhore. Sipas tij, shpenzimi për fushatën ishte i kufizuar në 0.5 euro për një votues të regjistruar në secilën komunë. Në tri komuna me më pak se 5,000 votues të regjistruar, kufiri ishte 0.7 euro për një votues të regjistruar. KQZ-ja publikoi listën e komunave, ku jepte detaje për numrin e votuesve të regjistruar dhe shumën e shpenzimit që lejohet për secilën prej tyre, me një shumë të përgjithshme prej 886,869 eurosh për tërë Kosovën.

Secilit subjekt politik i kërkohet të paraqes një raport për deklarimin e financimit të fushatës jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve, duke përfshirë të gjitha degët e tij, duke detajuar të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë edhe burimet e donacioneve. Zyra e KQZ-së për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike (ZRCPP) është përgjegjëse për monitorimin e respektimit të këtyre rregullave. Sipas ndryshimeve në Ligjin për Financimin e Partive Politike të korrikut 2013, së paku 10 auditorë të licencuar janë përzgjedhur nga Kuvendi i Kosovës në një tender të hapur përmes Komisionit të tij për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të cilët janë përgjegjës për auditimin e raporteve financiare të partive politike. Raportet e subjekteve politike duhet të publikohen në faqen e internetit të KQZ-së.

Subjektet politike kanë mundësi që të paraqesin raport të korrigjuar pasi të informohen nga auditorët për lëshimet e identifikuar. Megjithatë, ZRCPP e informoi MBEVZ-në se auditorët nuk kontrollojnë se sa janë të plota shënimet e partive politike (d.m.th që të gjitha shpenzimet e fushatës të pasqyrohen në raportet e paraqitura). Mos kontrollimi se a janë të plota të dhënat nënkupton se ka më pak gjasa që të identifikohen donacionet e paregjistruara. Në këtë rast, qëllimi i vendosjes së kufizimeve për shpenzimet e fushatës, dhe që subjektet politike të mos mund të shpenzojnë mbi këtë kufizim, nuk do të përmbushet.

## **X. AMBIENTI MEDIATIK**

### **A. Peizazhi mediatik**

Në Kosovë janë 105 media transmetuese, 84 radiostacione dhe 21 televizione, tetë gazeta ditore dhe një numër i madh i mediave online. Televizioni është burimi më i rëndësishëm i informacionit, veçanërisht jashtë Prishtinës.

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është transmetuesi publik me dy kanale televizive, *RTK1* në gjuhën shqipe dhe nga qershori 2013 edhe *RTK2* në gjuhën serbe, si dhe me dy radiostacione. Përderisa *RTK1* mbulon tërë Kosovën dhe konsiderohet si një ndër mediat më me ndikim, *RTK2* transmeton vetëm në rrjetin kabllor dhe praktikisht nuk arrin në komunat veriore. Dy kanale private *Koha Vision (KTV)* dhe *TV21*, kanë mbulueshmëri kombëtare tokësore. Një transmetues tjetër kryesor privat, *Klan Kosova*, mund të shikohet në tërë vendin përmes rrjetit kabllor. Derisa mediat

e shkruara përballen me tirazh të kufizuar dhe me rënie të ndikimit, roli i internetit dhe i leximit të mediave online, përfshirë edhe një numër portalesh që merren me politikë, është duke u rritur.

Bashkëbiseduesit e MBEVZ-së folën pozitivisht për ambientin e larmishëm mediatic dhe për llojllojshmërinë e burimeve të informacionit. Megjithatë, ata po ashtu treguan për problemet e vazhdueshme, përfshirë vështirësitë financiare, të cilat i bëjnë mediat të cenueshme nga ndikimet politike, si dhe për modelin e financimit të mediumit publik, i cili aktualisht bazohet kryesisht në buxhetin e shtetit.

## B. Korniza ligjore

Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes dhe pluralizmin mediatic. Në prill 2012, Kuvendi i Kosovës e de-kriminalizoi shpifjen dhe në tetor pas protestave nga organizatat e mediave, ai i tërhoqi dy nenet e kodit penal të miratuar rishtazi sipas të cilëve gazetarët do të mund të burgoseshin për shkeljet e bëra përmes mediave ose për refuzimin që të zbulojnë burimet e tyre.

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) dhe Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës përcaktojnë ca rregulla për mbulimin mediatic nga transmetuesit. Ky i fundit përcakton se politika redaktuese e RTK-së duhet të jetë e pavarur, e drejtë, profesionale, objektive, e balancuar dhe e paanshme. Megjithatë, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përmban rregullat kryesore për fushatën zgjedhore në media. Më 25 shtator 2013 KPM miratoi udhëzimet për zbatimin e këtyre rregullave.

Sipas LZP-së, gjatë periudhës zyrtare të fushatës, si transmetuesit publik ashtu edhe ata privatë janë të obliguar të sigurojnë mbulim të drejtë dhe të paanshëm në lajme. Përveç kësaj secili subjekt i regjistruar politik ka të drejtë në të paktën 30, respektivisht 40 minuta të kohës së transmetimit pa pagesë në televizionin publik dhe në radion publike. Pastaj, të gjithë transmetuesit privatë që vendosin të transmetojnë reklama me pagesë, duhet tu ofrojnë kohë të njëjtë të transmetimit secilit subjekt politik të certifikuar, me një numër minimal të minutave varësisht nga shtrirja gjeografike e transmetuesit. Edhe pse nuk ka ndonjë kufizim të kohës së transmetimit me pagesë, çmimet që caktohen për spote me pagesë nuk duhet të jenë më të larta se sa tarifa më e ulët që është paguar për të njëjtën kohë në gjashtë muajt e fundit. Mediave të shkruara po ashtu u lejohet të ofrojnë hapësirë pa pagesë dhe me pagesë, me kushte të barabarta për të gjitha subjektet politike.

Ligji po ashtu e obligon KPM-në që të mbikëqyr respektimin e dispozitave ligjore nga mediat transmetuese, duke e bërë këtë edhe përmes monitorimit të mediave. Zyra Ekzekutive e KPM-së i ka monitoruar mediat gjatë fushatës dhe MBEVZ-ja është informuar se mediat, përfshirë edhe transmetuesit publik, kanë respektuar kushtet sa i përket ndarjes së kohës pa pagesë.

Megjithatë, fakti se Komisioni përbëhet nga persona të emëruar prej partive politike ka ndikuar negativisht në punën e tij. Dy nga shtatë pozitat kanë mbetur të zbrazëta që prej emërimit të anëtarëve për shkak të mospajtimeve politike në Kuvendin e Kosovës. Më 30 tetor, Komisioni Parlamentar për Media<sup>†</sup> konstatoi se dy anëtarë të tjerë kishin shkelur Ligjin për KPM-në për pjesëmarrje në fushatën zgjedhore dhe miratoi propozimin e Kuvendit për t'i shkarkuar ata, si dhe kryesuesin e KPM-së për shkelje të kushteve gjatë emërimit të tij në vitin 2012.

Në përgjithësi, KPM ka dështuar që të ushtrojë përgjegjësinë e vet ligjore për mbikëqyrjen e punës së mediave dhe për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me mediat. Ky organ nuk mbajti asnjë takim zyrtar për të diskutuar këto ankesa ose konstatimet nga monitorimi i mediave i bërë nga Zyra ekzekutive gjatë tërë periudhës zgjedhore prej fillimit të fushatës zyrtare më 3 nëntor 2013.

<sup>†</sup> Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

MBEVZ-ja mësoi se ishin bërë 11 ankesa zyrtare për aspekte të ndryshme të mbulimit nga mediat që kishin të bënin më të dy rundet e zgjedhjeve. MVZ-së nuk ju dhanë kopjet e ankesave, me sqarimin se ishin duke vazhduar procedurat. KPM-ja përmes monitorimit të mediave *ex officio* identifikoi edhe 13 raste të tjera, që kryesisht kishin të bënin me praninë e fëmijëve në spote televizive, ose me shkeljen e heshtjes zgjedhore duke paraqitur pikëpamjet e përfaqësuesve politikë pas hedhjes së votës së tyre. Në tri raste të tilla, KPM-ja vendosi të bëjë paralajmërim me shkrim. Këto paralajmërimet me shkrim bazoheshin në dispozitën e LZP-së e cila e ndalon transmetimin e aktiviteteve të fushatës gjatë heshtjes parazgjedhore. Në udhëzimet e saj, KPM-ja mori një qasje më kufizuese dhe e zgjeroi këtë ndalesë për të përfshirë edhe çdo deklaratë të subjekteve politike lidhur me zgjedhjet.

### C. Gjetjet nga monitorimi i mediave

Në bazë të analizës cilësore dhe sasiore, MBEVZ-ja e monitorojë mbulimin politik të tetë kanaleve televizive, dy radiostacioneve, dy mediave online dhe tri gazetave.<sup>‡</sup>

Në përgjithësi, para të dy rundeve zgjedhore, mediat u ofruan subjekteve politike mënyra të ndryshme për shpërndarjen e mesazheve të tyre tek elektorati, dhe u ofrua votuesve informacione të larmishme për tu mundësuar atyre të bëjnë zgjedhje të informuar. Liria e shprehjes u respektua. Megjithatë, në një shembull të rëndësishëm negativ, kryeredaktorja e gazetës *Kosova Sot* u kërcënua pas foto-raportimit kritik për komunën e Prishtinës.

Mbulimi i lajmeve në përgjithësi pasqyrore përmasën e aktiviteteve të fushatës së kandidatëve, kështu që subjektet më aktive politike ishin të mbuluara më së shumti. Mediat nacionale i kushtuan vëmendje të veçantë fushatës në Prishtinë. Rregullisht u mbuluan edhe komunat e tjera, si me lajme ashtu edhe debate, megjithatë, paraqitja, veçanërisht në rundin e parë, në masë të madhe përcaktohej nga prania e udhëheqësve të partisë e jo nga aktiviteteve të kandidatëve komunalë ose e temave lokale. Fokusi i mediave pothuaj pa dallim varej nga gjuha e transmetimit. Mediat në gjuhën shqipe bënë vetëm një mbulim minimal subjekteve politike që përfaqësonin komunitetin serbë dhe komunitetet e tjera jo-shumicë, përderisa kanalet televizive në gjuhën serbe që u monitoruan në masë të madhe i shmangnin subjektet politike që përfaqësonin shumicën shqiptare.

### RUNDI I PARË

Fushata ishte shumë e pranishme në mediat nacionale, me një mbulim të gjerë në lajme, me një numër të madh të spoteve me pagesë dhe numër të madh të debateve televizive që mbulonin komunat e ndryshme. Përderisa mediat lokale, si *Tema TV* në Ferizaj dhe kanalet televizive private në gjuhën serbe të rrjetit *Mreža*, u ofruan shikuesve material shtesë lidhur me zgjedhjet, përfshirë debatet, mediat nacionale në përgjithësi u perceptuan si burime kryesore të informimit. Mediat sociale po ashtu u përdoren gjerësisht si platformë e re mediatike për të komunikuar me elektoratin, edhe pse shkalla e përdorimit të tyre ishte e ndryshme në pjesë të ndryshme të Kosovës.

PDK ishte më e mbuluara në lajmet e mediave në gjuhën shqipe. Në programet e veta të lajmeve, televizioni publik *RTK1* e mbuloi me raportet e veta më së shumti PDK-në, pasuar nga LDK-ja duke u ndarë atyre 27, respektivisht 22 për qind të mbulimit të përgjithshëm politik. Ky kanal raportoi më shumë për ngjarjet e PDK-së, se sa ato të LDK-së, 248 krahasuar me 187. Nga subjektet e tjera që janë mbuluar, koalicioni AAK-LDD dhe Vetëvendosje kishin marrë 15

<sup>‡</sup> Monitorimi filloi më 7 tetor për rundin e parë dhe më 6 nëntor për rundin e dytë, dhe u monitoruan këto media: *RTK1*, *RTK2* (Kanalet e Televizionit publik), *KTV*, *TV21*, *Klan Kosova*, *Most TV*, *Puls TV*, *RTS* (televizioni publik i Serbisë), *B92 Info* (vetëm për rundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave); *Radio Kosova* dhe *Radio Dukagjini* (radiostacione); *Kosova Sot*, *Koha Ditore* dhe *Zëri* (gazeta); dhe [www.gazetaexpress.org](http://www.gazetaexpress.org) dhe [www.telegrafi.net](http://www.telegrafi.net) (media online).

respektivisht 12 për qind të mbulimit politik. Të gjitha partitë ishin paraqitur kryesisht në mënyrë pozitive meqë kanali televiziv e mbuloi fushatën në programet e tij të lajmeve kryesisht sipas mundësive të mediumit dhe temave të ofruara nga kandidatët, me redaktim minimal. Çka është pozitive, televizioni publik po ashtu e minimizoi mbulimin e qeverisë (3 për qind), kështu që aktivitetet e përfaqësuesve të partisë në qeveri në kapacitetin zyrtar nuk ndikuan në fushatë.

Kanalit televiziv privat *Klan Kosova* kishte një përpjesëtim të ngjashëm të mbulimit me televizionin publik, me një mbulim më të madh të PDK-së dhe LDK-së, me 24 respektivisht 19 për qind, dhe 17 dhe 12 për qind për AAK-LDD dhe Vetëvendosjen.

Televizioni privat *TV21* u ofroi shikuesve të vet një portretizim sasior të balancuar të shumicës së kandidatëve më aktiv, duke i dhënë PDK-së, koalicionit AAK-LDD, LDK-së dhe Vetëvendosjes ndërmjet 15 dhe 23 për qind. Toni për të gjitha subjektet politike të mbuluara ka qenë krejtësisht pozitiv. Disa media të tjera, siç janë mediat e Grupit Koha, d.m.th, *KTV* dhe *Koha Ditore*, gazetë, kishin një qasje tjetër, me një mbulim mjaft kritik të PDK-së dhe qeverisë.

Të gjitha kanalet kryesore po ashtu transmetuan programe analitike dhe debate të shumta. Debatet e transmetuara në *TV21* u zhvilluan në komunat përkatëse, dhe qasja me audiencën ishte interaktive. Debatet e zhvilluara në *Klan Kosova* përfshinin përfaqësuesit e vetëm gjashtë subjekteve politike aktive.

Kanali televiziv publik në gjuhën serbe *RTK2* ofroi mbulim të balancuar në lajme për shumicën e subjekteve politike aktive që kishin në shënjestër votuesit serbë, siç janë SLS dhe 'G.I. Srpska', duke u ndarë atyre 21 dhe 20 për qind, duke i dhënë nivel të ngjashëm të vëmendjes Qeverisë së Kosovës dhe Serbisë. Kanali po ashtu transmetoi debate me kandidatët që bënë fushatë për votat e serbëve, malazezve dhe boshnjakëve. Nga kanalet televizive private në gjuhën serbe që u monitoruan, *TV Most* tregoi anshmëri në favor të 'G.I. Srpska'.

Ndonëse të dy radiostacionet e monitoruara kishin një mbulim të balancuar, radiostacioni publik Radio Kosova ishte me e detajuar, përderisa Radio Dukagjini transmetoi raporte faktike dhe informative. Mediat online të monitoruara në përgjithësi e kufizuan mbulimin e tyre në transmetimin e mesazheve politike nga burimet e tjera, duke shmangur në masë të madhe raportimin analitik. Megjithatë, lexuesit mund të gjenin një qasje më analitike në mediat e shkruara. Gazeta me tirazhin më të madh *Kosova Sot* pati një mbulim negativ të LDK-së, kryesisht përmes kritikave për kryetarin në detyrë të Prishtinës dhe udhëheqësin e LDK-së, Isa Mustafa.

## **RUNDI I DYTË**

Mbulimi mediatik i zgjedhjeve gjatë tri javëve të para pas rundit të parë pati një rënie të dukshme krahasuar me periudhën para rundit të parë. Kjo qasje kryesisht ishte për shkak të aktiviteteve të kufizuara të kandidatëve. Sidoqoftë, disa transmetues si *Klan Kosova* dhe *KTV*, transmetuan disa debate në javët para fushatës zyrtare. Stacioni televiziv publik *RTK1* transmetoi një debat ndërmjet kandidatëve të Prishtinës, përfshirë edhe udhëheqësin e LDK-së, Isa Mustafa, i cili më herët nuk kishte marrë pjesë në asnjë debat. Pak para fushatës zyrtare, *TV21* filloi një seri debatesh, duke përfshirë ekspertët dhe anëtarët potencialë të kuvendeve të zgjedhur me 3 nëntor.

Para fillimit të fushatës zyrtare, mbulimi në lajmet e mediave transmetuese ishte dominuar nga një raportim i zgjeruar për aktivitetet e organeve zyrtare. Televizioni privat *TV21* ia dedikoj pjesën më të madhe të mbulimit të lajmeve Qeverisë, kryesisht me ton neutral. Televizioni publik *RTK1* dhe ai privat *KTV* po ashtu i dedikuan një pjesë mjaft të madhe të mbulimit Qeverisë. Derisa shumica e mbulimit të *KTV*-së ishte neutrale, mbulimi i *RTK1* ishte kryesisht neutral dhe pozitiv. Transmetuesi privat *Klan Kosova* u fokusua edhe para fillimit të fushatës zgjedhore në dy subjekte që po garonin në numrin më të madh të balotazheve, LDK dhe PDK.

Fushata u bë më e dukshme pas fillimit zyrtar të saj. Media i kushtoi vëmendje të madhe disa komunave të caktuara, veçanërisht Prishtinës dhe Gjakovës. Nga mediat monitoruara, *RTK1* mbuloi fushatën në numrin më të madh të komunave.

Ngjashëm me fushatën e rundit të parë, mbulimi mediatik pasqyroi aktivitetin e subjekteve politike ku LDK ishte subjekti që u mbulua më së shumti në shumicën e mediave në gjuhën shqipe që u monitoruan. Gjatë periudhës së fushatës zyrtare, një vëmendje e konsiderueshme e mediave i ishte kushtuar një video-incizimi i cili pretendohet se paraqiste anëtarët e LDK-së duke bërë presion mbi një aktivist të Vetëvendosjes për t'iu bashkuar LDK-së. LDK-ja i kundërshtoi këto pretendime. Raportimi i mediave për këtë video rezultoi me rritjen e vëmendjes ndaj LDK-së në ditët e fundit të fushatës, kryesisht nga *KTV*, e cila bëri një mbulim negativ lidhur me këtë video. Kanali publik *RTK1* i paraqiti të gjitha partitë kryesisht në mënyrë pozitive dhe neutrale, dhe mbulimi i LDK-së disi u shënuar nga kjo video. *Klan Kosova* pati një qasje të barabartë për garuesit kryesorë.

Mbulimi mediatik në të gjitha kanalet televizive në gjuhën serbe ishte dukshëm i ndikuar nga koha e transmetimit që i dedikohet përfaqësuesve zyrtarë serbë nga Serbia të cilët zakonisht e përkrahnin listën e 'G.I. Srpska'. Ky subjekt politik kishte një mbulim preferencial në lajme në të gjitha kanalet televizive në gjuhën serbe, me përpjesëtimin më të madh (79 për qind) në *TV Most*.

Derisa mediat online dhe ato të shkruara në përgjithësi kishin një vijë të ngjashme të raportimit me atë të rundit të parë, disa media, veçanërisht *Koha Ditore*, i dedikoi më shumë vëmendje akuzave të shumta për blerje të votave.

## **XI. KONTESTET ZGJEDHORE**

E drejta e çdo personi për të përdorur mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që shkelin të drejtat ose interesat e tij/ saj garantohet me Kushtetutën e Kosovës. Kodi penal i përkufizon veprat penale që lidhen me zgjedhjet dhe i parasheh ndëshkimet. Policia, prokuroria dhe gjykatat e zbatojnë legjislacionin e zgjedhjeve, edhe pse nuk ka prokurorë ose gjykatat të veçanta për zgjedhjet. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e përcakton themelimin e një strukture qendrore për ankesa kundër shkeljeve administrative lidhur me zgjedhjet.

### **A. Parashtrësas dhe ankesat**

Sistemi është i centralizuar në një institucion të veçantë të pavarur, Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësas (PZAP), i cili është përgjegjës për të vendosur për të gjitha ankesat lidhur me tërë procesin zgjedhor (përveç për sfidat e listave të votuesve dhe ankesave lidhur me mediat). Kryetari i Gjykatës Supreme e emëron kryesuesin e PZAP-së nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Paneli përbëhet nga dhjetë gjyqtarë, përfshirë edhe kryesuesin. Ai ka një Sekretariat të përhershëm i cili e bën punën e nevojshme ligjore e cila përbën bazën për vendimet e gjyqtarëve. Ai po ashtu e menaxhon administratën dhe buxhetin. PZAP-ja financohet në mënyrë të pavarur nga Buxheti i Kosovës.

Ankesat e parashtruara në PZAP kishin të bënin me sjelljen gjatë fushatës, mbarëvajtjen e votimit, numërimin dhe tabelimin e rezultateve, si dhe kontestimin e rezultateve të zgjedhjeve. PZAP-ja po ashtu vepron si organ i shkallës së dytë, duke u marrë me ankesat ndaj vendimeve të marra nga KQZ-ja lidhur me certifikimin e subjekteve politike, akreditimin e vëzhguesve, regjistrimin e partive dhe votimin jashtë Kosovës. Vendimet e PZAP-së janë të obligueshme për KQZ-në, e cila është e obliguar që t'i zbatojë ato. Megjithatë, kundër vendimeve të PZAP-së, si për parashtrësas ashtu edhe për ankesat, mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Supreme. KQZ-ja i certifikon rezultatet përfundimtare vetëm pasi PZAP-ja të ketë vendosur për të gjitha parashtrësas ose Gjykata Supreme të ketë vendosur për të gjitha ankesat kundër vendimeve të PZAP-së.

Amendamentet e LZP-së në tetor 2010 sollën ndryshime substanciale në procedurat e parashtrësive dhe ankesave. Procedurat tani janë më të detajuara dhe dënimet e shqiptuara nga PZAP-ja janë përshtatur për të pasqyruar shkeljet. Roli i Panelit është sqaruar dhe forcuar. Sidoqoftë, puna e Panelit është dëshmuar të jetë shumë sfiduese në shumë aspekte gjatë këtyre zgjedhjeve lokale.

Parashtruesi i ankesës mund të jetë çdo person, fizik ose juridik, i cila ka interes në një çështje, ose të drejtat e të cilit lidhur me procesin zgjedhor mendohet se janë shkelur. Megjithatë, në përgjithësi kanë qenë subjektet më të mëdha politike ato që e kanë shfrytëzuar mundësinë për tu ankuar. Afatet për paraqitjen e ankesave dhe që PZAP-ja të vendos për to janë mjaft të shkurtra, veçanërisht për ankesat që kanë të bëjnë me votimin dhe numërimin. Ankesat lidhur me procesin e votimit duhet të paraqiten brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve. Ankesat lidhur me numërimin dhe rezultatet duhet të paraqiten brenda 24 orësh nga shkelja e supozuar. Në secilin rast, PZAP-ja ka 72 orë nga pranimi i ankesës që të merr vendim. Si rezultat i këtyre afateve të shkurtra kohore, ka qenë e vështirë që parashtruesit e ankesave të përgatisin ankesat e tyre si duhet ose që PZAP-ja t'i shqyrtojë ato në mënyrë të plotë.

Për këto zgjedhje për kuvende komunale dhe për kryetarë të komunave, PZAP-ja ka pranuar gjithsejtë 1,070 parashtrësia, 37 ankesa kundër vendimeve të KQZ-së për regjistrimin dhe certifikimin e kandidatëve dhe subjekteve politike dhe 16,355 ankesa kundër vendimeve të KQZ-së për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës.

Në lidhje me periudhat zyrtare të fushatës zgjedhore para dy rundeve zgjedhore, PZAP shqyrtoi 279 ankesa. Shumica ishin parashtruar nga subjektet politike dhe kishin të bënin me kodin e mirësjelljes, gjegjësisht me dëmtimin ose vendosjen e parregullt të posterëve, për të cilat PZAP-ja shqiptoi gjoba në shumën e përgjithshme prej 184,500 eurosh. Subjektet politike janë të obliguara të paguajnë ose të rrezikojnë që të mos certifikohen në zgjedhjet e ardhshme. Nëse një subjekt politik i dënuar nuk i paguan gjobat, vlera gjobave i zbritet nga shuma e zyrtare parave që i ndahen atij subjekti për zgjedhjet e ardhshme. LZP-ja thekson se subjektet politike janë përgjegjëse për shkeljet e Kodit të mirësjelljes që i bëjnë anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre. Disa bashkëbisedues të MBEVZ-së kishin vërejtje se gjobat ishin tepër të larta, dhe e konsideronin jo të drejtë një 'dënim të tillë kolektiv' të subjekteve politike për shkeljet e bëra nga anëtarët e tyre.

Pas rundit të parë të zgjedhjeve, PZAP pranoi 173 ankesa lidhur me ditën e zgjedhjeve dhe 322 lidhur me numërimin dhe tabelimin e rezultateve, përfshirë edhe 69 të pranuar pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për kryetarë të komunave. Lidhur me rundin e dytë, PZAP-ja pranoi 46 ankesa për votim dhe numërim. Megjithatë, kapaciteti i PZAP-së ishte shumë i ngarkuar për faktin se rezultatet e zgjedhjeve për kuvendet komunale ishin shpallur një ditë pas rundit të dytë të zgjedhjeve dhe në të njëjtën kohë ishin pranuar edhe 250 ankesa nga subjektet politike që kontestonin ato rezultate.

Në përgjithësi, PZAP-ja veproi në mënyrë të organizuar, ju përmbajt afateve kohore dhe e mundësoi qasjen në vendimet e saj duke i vënë ato në faqen e saj të internetit. Siç lejohet me ligj, Paneli i bashkoi ankesat e ngjashme nga komuna e njëjtë, dhe i trajtoi ato si një. Të gjitha vendimet e PZAP-së që u monitoruan nga MBEVZ-ja ishin marrë me konsensus. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të ankesave, gjyqtarët e PZAP-së kryesisht aplikonin një qasje formaliste, shpesh pa i hetuar dëshmitë. Prej të gjitha ankesave lidhur me votimin në dy ditët e zgjedhjeve, asnjë nuk u miratua. Prej atyre që kishin të bënin me numërimin dhe tabelimin e rezultateve, PZAP-ja miratoi vetëm dy nga rundi i parë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave, dhe 14 të tjera për zgjedhjet për kuvende komunale, duke e udhëzuar KQZ-në që ose të bëjë rinumërimin e votave ose, në një rast për rundin e parë, të përsëriten zgjedhjet. Në rastet e tjera, KQZ urdhëroi rinumërimin ose përsëritjen e zgjedhjeve.

Në marrjen e vendimeve të tij për ankesat, PZAP jo gjithmonë inicioi hetime dhe nuk mbajti seanca dëgjimore. Ligji i jep PZAP-së mundësinë, por nuk e obligon atë, që të mbajë seanca dëgjimore.

Parashtruesi i ankesës është i obliguar të paraqes dëshmi, të cilat janë komponent thelbësor i të drejtës për të parashtruar ankesë. Megjithatë, nëse nuk ka seancë dëgjimore, kjo e drejtë është e kufizuar në atë që ka qenë në gjendje parashtruesi i ankesës të përmbledh brenda 24 orësh në ankesën me shkrim. Për më tepër, në rrethana të tilla, subjekti i ankesës nuk e ka mundësinë e plotë të paraqes qëndrimin e vet. Kjo është në kundërshtim me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Përderisa ligji nuk e obligon Panelin të bëj hetime proaktive në secilin rast, ai i jep atij këtë mundësi kur dyshohet se një ankesë mund të përfshijë aktivitete mashtruese lidhur me materialet zgjedhore. Paneli nuk e ka përdorur shpesh këtë opsion. Në përgjithësi, PZAP-ja i zgjidhi ankesat brenda afatit ligjor, por në mungesë të dëshmive të nevojshme, shumicën prej tyre i hodhi poshtë, pa bërë hetime se a kanë mundur të ndodhin ato parregullsi. Sipas bashkëbiseduesve të MBEVZ-së, kjo ndikoi në besimin e disa prej palëve të interesit në këtë organ.

Shkeljet që kanë për qëllim të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve, përveç të qenit shkelje administrative, mund të jenë edhe vepra penale. Në raste të tilla, PZAP-ja duhet të përcjell rastin në zyrën e Kryeprokurorit për ndjekje penale. Por kjo nuk duhet ta lirojë PZAP-në nga juridiksioni që ka për të vendosur detyrimin administrativ. Asnjë ankesë nuk i është përcjellë Kryeprokurorit për hetim, por PZAP-ja ka shkëmbyer informata dhe ka kërkuar dëshmi nga policia në 24 raste.

Numri shumë i madh i parashtrësve dhe ankesave që u pranuan brenda një periudhe të caktuar kohore e ngarkoi kapacitetin e Sekretariatit të PZAP-së pothuaj deri në shkallë të pamendueshme. Periudha për marrjen e vendimeve për ankesat e pranuar prej jashtë Kosovës përkoi me afatet kohore për ankesat e fushatës. Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale vetëm një ditë pas ditës së votimit të rundit të dytë nënkuptonte se edhe periudha e parashtrimin të ankesave për votimin në rundin e dytë dhe për kontestimin e rezultateve të rundit të parë të zgjedhjeve përkonin me këtë. Periudha e gjatë para shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve, e kombinuar me afatet e shkurtra kohore të përcaktuara me ligj për PZAP-në që të merr vendim, ua bën tepër të vështirë gjyqtarëve të përdorin të gjitha mundësitë që ua lejon ligji për të luajtur rol më proaktiv hetues ose për të mbajtur seanca dëgjimore. Duke marrë parasysh kombinimin e afateve të shkurtra dhe kapaciteteve të kufizuara, gjyqtarët nuk i dedikuan kohë të mjaftueshme diskutimit dhe marrjes së vendimeve dhe orientimit të punës së zyrtarëve ligjor.

Struktura e përhershme e PZAP-së, me numrin e tanishëm të gjyqtarëve dhe punonjësve, është dëshmuar jofunksionale gjatë periudhës së zgjedhjeve, atëherë kur puna e saj është më e rëndësishmja. Duhet të mendohet për forcimin e kapacitetit të Sekretariatit, i cili e ka përgjegjësinë më të rëndësishme në përgatitjen ligjore të vendimeve që duhet t'i marrin në konsideratë gjyqtarët, përveç të gjitha funksioneve të tjera administrative.

Në përgjithësi, jo gjithmonë është respektuar e drejta për të shfrytëzuar mjetin juridik efektiv lidhur me realizimin e të drejtave zgjedhore, siç përcaktohet në nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 13 të KEDNJ-së. Për më tepër, PZAP nuk është gjykatë e cila është pjesë e Sistemit Gjyqësor të Kosovës, por është një organ i pavarur i përbërë nga gjyqtarët. Neni 14 i KNDCP thekson se çdokush ka të drejtë në dëgjim të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar sipas ligjit. Ndonëse paanshmëria e PZAP-së nuk është vënë në dyshim, e vetmja pjesë e procesit të ankimimit ku intervenon gjykata e themeluar me ligj është faza e ankesës në Gjykatën Supreme. Por përqindja e parashtrësve të ankesave që e shfrytëzuan këtë shkallë të fundit ishte shumë e ulët. Prej të gjitha ankesave të hedhura poshtë nga PZAP-ja, vetëm për 24 prej tyre ishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Në 23 prej këtyre rasteve, Divizioni Administrativ i Gjykatës Supreme e mbështeti vendimin e PZAP-së, dhe në një rast i kërkoi PZAP-së ta rishikoi vendimin. Gjykata Supreme nuk mbajti seanca dëgjimore e as nuk i publikoi vendimet e veta, duke kufizuar transparencën e procesit të ankesave. Për të respektuar standardet ndërkombëtare, duhet të mendohet që PZAP-ja të bëhet pjesë e gjyqësorit të Kosovës. Po ashtu mund të merret në konsideratë edhe Decentralizimi i procesit të ankimimit, veçanërisht në rast se



do të decentralizohet edhe administrimi i zgjedhjeve, për të rritur rolin e KKZ-ve. Në nivel të gjykatës themelore, panelet zgjedhore me gjyqtarë të emëruar ose KKZ-të mund të merren me shkallën e parë të ankesave.

## **B. Realizimi i të drejtave zgjedhore**

Pas përvojës së zgjedhjeve të kaluara, kur pati numër të madh të akuzave për shkelje të të drejtave zgjedhore, Kodi i ri Penal i cili hyri në fuqi më 1 janar 2013 përfshiu disa ndryshime substanciale me qëllim të dekurajimit të mashtrimeve në zgjedhje. Numri i veprave penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet është shtuar nga gjashtë në dhjetë. Ato tani përfshijnë edhe shkeljen e të drejtës për të qenë kandidat, kërcënimet ndaj kandidatëve, pengimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar, cenimin e vendimit të lirë të votuesve, abuzimin e detyrës, dhënien apo marrjen e mitos lidhur me votimet, abuzimin me të drejtën për të votuar, shkeljen e fshehtësisë së votës, pengimin e procesit të votimit, falsifikimin e rezultateve të votimit dhe shkatërrimin e dokumenteve të votimit. Dënimet e parapara për secilin krim janë rritur, përfshirë edhe burgimin deri në pesë vjet për një numër shkeljesh.

Për të informuar publikun e gjerë për këto ndryshime dhe për të siguruar zbatimin e tyre, me 18 shtator 2013 u nënshkrua një Memorandum i Mirëkuptimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Policisë së Kosovës, KQZ-së dhe PZAP-së. U krijua edhe një Task Force me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit në mes të këtyre institucioneve në trajtimin e veprave penale të kryera kundër të drejtave zgjedhore. Zyra e Prokurorit dhe Policia e Kosovës u koordinuan në mënyrë efektive në bërjen publike të dënimeve për shkeljet gjatë zgjedhjeve dhe në veprimin kundër këtyre shkeljeve. Një nga prokurorët e shtetit u emërua si koordinator shtetëror dhe e udhëhoqi punën e Task Forcës, duke e përfaqësuar atë në media. U zhvillua një fushatë publike përfshirë edhe spote mediatike, me qëllim të rritjes së vetëdijesimit të zyrtarëve të zgjedhjeve, autoriteteve dhe votuesve për punën e Task Forcës. Janë organizuar gjashtë tryeza të rumbullakëta para rundit të parë të zgjedhjeve në gjashtë rajonet gjyqësore kryesore të Kosovës. Janë shpërndarë broshura me informata për legjislacionin e ri penal, për rolin e institucioneve të ndryshme të përfshira në zgjedhje dhe për numrin e telefonit të policisë me qëllim të inkurajimit të njerëzve që të raportojnë shkeljet gjatë zgjedhjeve.

Për dy ditët e zgjedhjeve, Kryeprokurori shpërndau 50 prokurorë për rundin e parë me 3 nëntor dhe 60 për rundin e dytë më 1 dhjetor, të cilët vepruan në koordinim të ngushtë me policinë dhe me gjyqtarët e gjykatave themelore që ishin kujdestar. Gjatë dy ditëve të zgjedhjeve, u arrestuan 117 veta. Si rrjedhojë, u iniciuan 19 raste penale që përfshinin 32 persona, përfshirë 14 zyrtarë të zgjedhjeve. Gjyqtarët ishin udhëzuar që këto raste t'i trajtojnë me prioritet. Në përgjithësi, besohet se dënimet e ashpra të parapara, bashkë me fushatën e informimit publik për të paralajmëruar ata që bëjnë shkelje zgjedhore për pasojat e mundshme kanë pasur efekt në dekurajimin e shkeljeve të rregullave zgjedhore.

## **XII. KOMUNITETET JO-SHUMICË**

Barazia e personave para ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore të njohura ndërkombëtarisht janë të mishëruara në legjislacionin e Kosovës. Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë rregullohen me Kushtetutë dhe me ligjet e tjera, përfshirë edhe LZP-në dhe LZL-në. Ligjet e tjera të rëndësishme përfshijnë Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë, i ndryshuar në dhjetor 2011 dhe gusht 2012, dhe Ligjin për Gjuhët.

Për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, LZP-ja përcakton vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë, kështu që deklarimi i përkatësisë së tyre etnike është pjesë e procesit të

certifikimit të tyre nëse ata duan të garojnë për ato vende. Edhe pse në zgjedhjet për kuvendet komunale nuk ka vende të rezervuara për komunitetet jo-shumicë, prapëseprapë, janë të rralla partitë politike që veprojnë përtej vijave etnike. Fushatat zgjedhore në përgjithësi kishin si synim grupet individuale etnike, dhe subjektet më të mëdha politike nuk adresonin brengat specifike të pakicave. Megjithatë, të gjitha subjektet politike të komuniteteve jo-shumicë ishin në gjendje të merrnin pjesë aktive në procesin zgjedhor, përfshirë edhe negociatat me subjektet garuese të përfshira në balotazh.

Nga 103 subjektet politike të certifikuara nga KQZ-ja për zgjedhje, 52 përfaqësonin komunitetet pakicë (28 serbe, 11 boshnjake, 3 malazeze, 3 turke, 2 rome, 2 ashkali, 1 egjiptiane, 1 gorane dhe 1 kroate). Të gjitha kanë fituar të paktën nga një ulëse në kuvendin komunal. Vetëm disa prej tyre kanë paraqitur kandidatura për kryetar të komunës, nga të cilat kandidatët serbë fituan në 10 komuna me shumicë serbe, dhe një kandidat në një komunë me shumicë turke.

Ekzistojnë garanci për përfaqësimin e pakicave në organet lokale legjislative dhe ekzekutive. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përcakton se në ato komuna ku së paku 10 për qind e popullsisë i takon komuniteteve jo-shumicë, posti i Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Pakicat duhet të rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. Madje, posti i zëvendës kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete duhet të mbahet nga kandidati i komunitetit jo-shumicë që ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve në zgjedhjet për kuvend komunal. Në zgjedhjet për kryetarë të komunës, në komunat ku 10 për qind e votuesve të regjistruar janë nga komunitetet jo-shumicë, duhet të ketë një zëvendës kryetar për komunitete.

Në lidhje me përfaqësimin e pakicave në organet për menaxhimin e zgjedhjeve, legjislacioni parasheh që anëtarët e KKZ-së dhe KVV-së duhet të paraqesin përbërjen e komuniteteve të ndryshme në komunë. Megjithatë, vëzhguesit afatgjatë vërejtën se komunitetet pakicë përveç serbëve dhe shqiptarëve (në zonat ku serbët përbëjnë shumicën) nuk ishin gjithmonë të përfaqësuar në përpjesëtim me numrin e tyre.

### **XIII. VËZHguesIT VENDORË**

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme parashikon se mund të ketë edhe vëzhgues vendorë edhe ndërkombëtarë të zgjedhjeve. KQZ-ja ka akredituar më shumë se 32,000 vëzhgues në mënyrë përfshirëse, duke përmirësuar transparencën e procesit zgjedhor. Pothuaj 29,000 prej tyre ishin nga subjektet politike, dhe numri më i madh ishte nga PDK dhe LDK. Afër 2,500 vëzhgues ishin akredituar nga organizatat e shoqërisë civile.

Demokracia në Veprim, një koalicion i organizatave të shoqërisë civile, e vëzhgoi tërë procesin zgjedhor dhe vendosi vëzhgues në qendrat e votimit në tërë Kosovën për të dy rundet e zgjedhjeve. Ajo lëshoi deklaratë lidhur me gjetjet e saj dhe mbajti konferencë të shtypit gjatë ditës së zgjedhjeve. Dega në Kosovë e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dërgoi vëzhgues në disa lokacione të zgjedhura. Koalicioni për Monitorimin e Zgjedhjeve, i përbërë nga nëntë organizata të shoqërisë civile të komunitetit serb, shpërndau vëzhguesit në komunat me shumicë serbe. Edhe Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave pati vëzhgues në komunat me shumicë serbe në jug. Institucioni i Avokatit të Popullit po ashtu pati vëzhgues, duke u fokusuar në procesin e votimit për ata që janë të mbyllur në institucione si spitalet, institucionet e shëndetit mendor, burgjet dhe qendrat e paraburgimit.

### **XIV. VOTIMI DHE NUMËRIMI**

Në të dy rundet e zgjedhjeve, më 3 nëntor dhe 1 dhjetor, zgjedhjet kaluan në mënyrë të qetë dhe paqësore në pjesën më të madhe të Kosovës, pa incidente të mëdha. Njerëzit dolën në vendvotime

për të ushtruar të drejtën e tyre demokratike për të votuar, dhe hodhën votat e tyre në mënyrë të lirë pa u penguar. Vëzhguesit e MBEVZ-së vlerësuan pozitivisht procesin e votimit në shumicën e vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë, të dy rundet zgjedhore u karakterizuan me incidente të dhunshme ku u pushtuan qendrat e votimit, u thyen kutitë e votimit dhe ku u morën materialet zgjedhore, në Mitrovicën Veriore me 3 nëntor dhe në Partesh me 1 dhjetor. Përsëritja e zgjedhjeve në Mitrovicën Veriore më 17 nëntor dhe rundi i dytë i zgjedhjeve më 1 dhjetor u mbajtën me një nivel të lartë të sigurisë, ku u përfshi policia dhe ushtarët ndërkombëtarë, në mënyrë që të pengohet çdo përsëritje e ngjarjeve të 3 nëntorit.

Në vendvotimet e vëzhguara në të dy rundet, kishte një mbizotërim të anëtarëve meshkuj të KVV-ve, dhe në një të katërtën e tyre të gjithë anëtarët e KVV-ve ishin meshkuj. Në një numër të madh të vendvotimeve nuk kishte mundësi të qasjes për persona me aftësi të kufizuara të cilët nuk kishin kërkuar të votojnë në shtëpi. Vëzhguesit e partive politike ishin të pranishëm në pothuaj të gjitha vendvotimet e vëzhguara, duke përmirësuar kështu besimin e palëve të përfshira. Vëzhguesit e shoqërisë civile ishin të pranishëm në rreth tri të katërtat e vendvotimeve. Ata e kishin një pasqyrë të qartë të procesit. Megjithatë, në një numër të vendvotimeve ata janë vërejtur duke ndërhyrë në procedura.

Në intervale të rregullta gjatë ditës së zgjedhjeve në të dy rundet, Task Forca e udhëhequr nga Kryeprokurori dha informata të përditësuara mbi numrin e rasteve penale të iniciuara për shkeljen e të drejtave zgjedhore, me qëllim të dekurajimit të shkeljeve zgjedhore. Prokurorët e caktuar nëpër Kosovë punuan së bashku me policinë për të zbatuar legjislacionin penal në ditën e zgjedhjeve. Ata deklaruan iniciimin e rasteve penale duke përfshirë dhe ato për votimin në emër të dikujt tjetër, posedimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pengimin e votimit, keqpërdorimin e detyrës, dhe shkeljen e vullnetit të lirë të votuesve. PZAP-ja pranoi ankesa lidhur me të dy ditët e zgjedhjeve, mes tjerash edhe për manipulim të materialit zgjedhor, blerje të votave dhe ndihmës në votim.

### **A. Rundi i parë, 3 nëntor 2013**

Në përgjithësi, zgjedhjet e rudit të parë më 3 nëntor 2013 u zhvilluan në atmosferë pozitive. Edhe në komnatat veriore njerëzit dolën për të votuar, edhe pse në Mitrovicën Veriore kundërshtuesit e zgjedhjeve u mblodhën jashtë disa qendrave të votimit dhe u përpoqën t'i bindin votuesit e mundshëm që të mos votojnë, ndonjëherë edhe me sukses. Vëzhguesit e MBEVZ-së shënuan disa raste të frikësimit në Mitrovicën Veriore dhe Leposaviq. Dita e zgjedhjeve në katër komnatat veriore u ndërpre për shkak të sulmeve në tri qendra të votimit në Mitrovicën Veriore dhe shkatërrimit të kutive të votimit në disa vendvotime. Kjo bëri që procesi zgjedhor të braktiset në tërë veriun. Kutitë e votimit nga komnatat e tjera veriore u sollën në një lokacion në jug, edhe pse në disa raste kishte shqetësime për sigurinë e një bartjeje të tillë.

MBEVZ-ja vëzhgoi hapjen, votimin, mbylljen dhe numërimin e votave në 460 vendvotime në tërë Kosovën. Hapja dhe votimi u vlerësuan pozitivisht në shumicën dërrmuese të vendvotimeve të vëzhguara. Edhe pse integriteti i votës duket se është mbrojtur mjaftueshëm në shumicën e vendeve, kishte disa raste të izoluara të shkeljeve të rënda, përfshirë edhe votimin e shumëfishtë, frikësimin dhe fotografimin e fletëvotimit gjatë votimit.

Fshehtësia e votës nuk u respektua gjithmonë. Në një numër të konsiderueshëm të vendvotimeve në tërë Kosovën janë vërejtur më shumë se një person në kabinën e votimit, shpesh për shkak të votimit familjar. Procedurat e votimit kryesisht janë respektuar, por kishte disa raste kur dokumentet e identifikimit nuk ishin kontrolluar ose kur nuk ishte bërë kontrolli i gishtërinjve për të parë se a kanë ngjyrë.

Kishte një mungesë konsekuente për atë se a duhet të pranohen dokumentet e identifikimit të Serbisë ose të UNMIK-ut për votim. Në natën e zgjedhjeve, KQZ-ja lëshoi udhëzimin ku përcaktohej se mund të përdoret çdo dokumenti vlefshëm i identifikimit, por nuk e specifikoi se a

përfshihen këtu edhe dokumentet e identifikimit të Serbisë. Kjo shpesh shkaktoi konfuzion tek stafi i KVV-ve. Në disa vendvotime të vëzhguara, fillimisht nuk u pranuan dokumentet serbe të identifikimit, por më vonë ato u pranuan, pasi që KVV-të u kontaktuan për këtë çështje nga KKZ-të dhe u informuan se ato duhet të pranojnë çdo dokument të vlefshëm të identifikimit, përfshirë edhe ato të Serbisë.

Në përgjithësi, numërimi u bë pa parregullsi serioze, edhe pse në disa raste u vërejtën gabime procedurale. Në disa vendvotime, nuk u numëruan nënshkrimet në listët e votuesve dhe në disa nuk u plotësuan si duhet protokollet e rezultateve.

Një numër shumë i madh, rreth 10 për qind, e fletëvotimeve në zgjedhjet për kuvendet komunale u shpallën të pavlefshme. Ndonëse shumë prej këtyre mund t'i atribuohen faktit se votuesit i kanë kuptuar dobët kushtet për shënimin e fletëvotimit, të tjerat mund të jenë bërë të pavlefshme për shkak të trajnimit të dobët dhe udhëzimeve të paqarta për KVV-të, duke ua hequr shumë votuesve të drejtën e votës.

### **B. Rivotimi në Mitrovicën Veriore, 17 nëntor 2013**

Gjatë zgjedhjeve të përsëritura më 17 nëntor në Mitrovicën Veriore, në shumë raste, punonjësit e institucioneve publike dhe familjet e tyre u urdhëruan të dalin për të votuar, siç u raportua, në mënyrë të organizuar. Një shtrëngim i tillë nuk është në pajtim me parimet për zgjedhje demokratike, dhe është në kundërshtim me nenin 25 të KNDCP.

Votimi kaloi pa incidente, me një prani të madhe të organeve sigurisë përreth qendrave të votimit, përfshirë praninë e policisë së Kosovës, EULEX-it dhe KFOR-it. Përkundër këtij ambienti, njerëzit ishin në gjendje të votojnë pa pengesë. MBEVZ-ja e vendosi një ekip të vëzhguesve afatgjatë, i cili vëzhgoi 13 nga 27 vendvotimet ku u zhvillua votimi. Ata vlerësuan pozitivisht mbarëvajtjen e votimit në të gjitha vendvotimet e vëzhguara, edhe pse në disa prej tyre janë vërejtur gabime procedurale. Vëzhguesit e subjekteve politike nuk ishin të pranishëm në asnjë prej vendvotimeve të vëzhguara, as me 17 nëntor e as në rundin e dytë në Mitrovicën Veriore me 1 dhjetor. Me rekomandimin e Misionit të OSBE-së, të bazuar në rrethanat e sigurisë, pas mbylljes së vendvotimeve, KQZ-ja deklaroi se materialet e votimit duhet të barten në QNR për numërim, edhe pse Ligji për Zgjedhjet Lokale thekson se numërimi duhet të bëhet në vendvotime. Numërimi është bërë nga KVV-të me mbështetjen e stafit të OSBE-së. MBEVZ-ja vlerësoi se numërimi është bërë në mënyrë shumë të organizuar dhe me respektim të rreptë të procedurave.

Rezultatet e përsëritjes së votimit në Mitrovicën Veriore treguan se do të ketë balotazh ndërmjet dy kandidatëve kryesor për kryetar të komunës, i cili u mbajt me 1 dhjetor. Kandidati i 'G.I. Srpska' i kontestoi rezultatet, duke pretenduar se votat janë prekur pas mbylljes së vendvotimeve. Ky pretendim u hodh poshtë në mënyrë kategorike nga OSBE.

### **C. Rundi i dytë, 1 dhjetor 2013**

MBEVZ vëzhgoi hapjen, votimin, mbylljen dhe numërimin në 330 vendvotime anekënd Kosovës në rundin e dytë të zgjedhjeve që u mbajtën më 1 dhjetor 2013, si dhe pranimin e materialeve zgjedhore në KKZ. Hapja dhe votimi u vlerësuan mirë apo shumë mirë në pothuajse të gjitha vendvotimet e vëzhguara. Votimi në dy komunat veriore me shumicë serbe kaloi qetë dhe me prani të madhe të [organeve të] sigurisë. Që prej 17 nëntorit, vëzhguesit e MBEVZ-së vërejtën se punonjësit e sektorit publik ishin nën presion të fuqishëm për të votuar. Shqetësime të ngjashme u vërejtën në komunën e Shtërpçës me shumicë serbe.

Që në raundin e parë, vëzhguesit vlerësuan se integriteti i votës ishte mbrojtur mjaftueshëm në shumicën e vendvotimeve. Megjithatë kishte raportime të fotografimit të fletëvotimeve në disa vende. Q[ me 3 nëntor, fshehtësia e votës nuk është siguruar gjithmonë. Në shumë vendvotime u

vërejtën më shumë se një person në kabinën e votimit. Sikurse votimi familjar, mundësia për të kërkuar ndihmë gjatë votimit u shfrytëzua mjaft shpesh, kurse vëzhguesit vërejtën dyshime të shumta se kjo mundësi edhe keqpërdorej. U vërejtën disa raste ku votuesit e tregonin fletëvotimin jashtë kabinës, në veçanti në Graçanicë dhe në Prishtinë. Procedurat e votimit kryesisht u respektuan, por vulat në fletëvotime shpeshherë nuk kontrolloheshin nga anëtarët e KKZ-së para se fletëvotimi të hidhej në kuti.

Në përgjithësi, numërimi u realizua më rrjedhshëm sesa në raundin e parë, që ndoshta pasqyron faktin se në shumicën e vendeve u mbajtën vetëm një palë zgjedhje, balotazhi për kryetarë të komunës, me vetëm dy kandidatë. Në përgjithësi procesi u realizua me shpejtësi dhe pa parregullsi serioze, kurse procedurat kryesisht u respektuan. Dorëzimi i materialeve zgjedhore në KKZ u vlerësua nga vlerësuesit si efikas dhe transparent, edhe pse në shumë raste, për dallim nga faza gjatë votimit dhe numërimit, vëzhguesit e shoqërisë civile dhe të partive politike nuk ishin të pranishëm. Në një incident serioz, në komunën e Parteshit, afër përfundimit të procesit të numërimit, njerëzit hynë me forcë në Qendrën e Votimit (me tri vendvotime) dhe vodhën apo shkatërruan kutitë dhe materialin zgjedhor. Përkundër raundit të parë më 3 nëntor dhe raundit të dytë më 17 nëntor, numërimi në Mitrovicën Veriore, si dhe në Zveçan (ku votimi u përsërit në tri vendvotime) u realizua në vendvotime, në pajtim me ligjin

## XV. SHPALLJA E REZULTATEVE

Nuk ekziston ndonjë afat ligjor për shpalljen e rezultateve në zgjedhjet komunale dhe dispozitat ligjore që rregullojnë tabelimin e rezultateve, shpalljen e rezultateve preliminare, ankesat dhe parashtrirat dhe certifikimin përfundimtar të rezultateve nuk janë të detajuara sa duhet. Procesit të tabelimit të rezultateve ishte i gjatë dhe rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për kryetar komune dhe kuvend komunal u certifikuan nga KQZ-ja vetëm me 11 dhjetor (përveç për një komunë, Parteshin, ku u urdhërua rivotimi për kryetar komune në tri vendvotime për 15 dhjetor).

Sipas ligjit, KQZ-ja mund të certifikojë dhe të publikojë rezultatet pasi KKZ-ja të pranojë rezultatet nga të gjitha vendvotimet, pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve me kusht, ato të personave me nevoja të veçanta dhe ato me postë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe pas vendosjes për të gjitha ankesat në lidhje me votimet dhe numërimet.

Pas zgjedhjeve të 3 nëntorit, QNR-ja pranoi materialet zgjedhore nga pothuajse të gjitha vendvotimet anekënd Kosovës. Rreth 530 kuti të votimit u futën në karantinë gjatë pranimit si rezultat i parregullsive të shumta (kryesisht për shkak se bllobat në kuti ishin ndërruar nga KKZ-të pasi që KVV-të gabimisht kishin vendosur formularët e rezultateve brenda kutive). Për një javë pas zgjedhjeve, stafi i QNR-së i verifikoi këto kuti dhe i cilësoi shumicën prej tyre si të rregullta pasi që parregullsitë nuk ishin aq serioze dhe nuk kishin shenja të manipulimit me të dhënat e regjistruara. Megjithatë, në 61 vendvotime, KQZ-ja urdhëroi rinumërimin i votave për kryetar komune kurse rezultatet nga tri vendvotime në Prizren u anuluan si rezultat i mungesës së listave të votuesve (përveç vendvotimeve të anuluar në veri - *shih më poshtë*). Si rezultat i pasaktësive në formularët e rezultateve për zgjedhjet për kuvendet komunale, QNR-ja më vonë rinumëroi mbi 300 kuti me vota për kuvendet komunale nga pothuajse çdo komunë në Kosovë. Pas balotazhit të 1 dhjetorit, vetëm 12 kuti me fletëvotime u futën në karantinë.

Pas përfundimit të parakohshëm të votimit në vendvotimet në katër komunat veriore më 3 nëntor, si rezultat i incidenteve që ndodhën në tri qendra të votimit në Mitrovicën Veriore, shumica e materialeve zgjedhore dhe kutive me fletëvotime u sollën në QNR për numërim. KQZ-ja vendosi që të pranojë dhe të numërojë fletëvotimet nga Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, dhe shpalli rezultatet për këto komuna përkundrejt faktit se votat nga pesë vendvotime (tri në Leposaviq dhe dy në Zveçan) u deshtë të anulohen si rezultat i mungesës së listave të votuesve. Në Mitrovicën Veriore, KQZ-ja vendosi që të pranojë rezultatet nga gjashtë vendvotime dhe të përsëris votimin në

27 vendvotimet tjera (që ndodhen në tri qendra të votimit ku ndodhën incidentet) më 17 nëntor. Më vonë, pas vendimit të KZAP-it, KQZ-ja vendosi që të përsëris zgjedhjet në tri vendvotime në Zveçan. Votimi në tri vendvotime në Leposaviq nuk u përsërit. Në ato vendvotime në veri ku votimi nuk u përsërit, përkundër faktit se ato u deshtë që të mbyllen para kohe pas incidenteve në Mitrovicën Veriore, votuesve që kishin ardhur më vonë për të votuar, iu mohua e drejta për të votuar.

KQZ-ja shpalli rezultatet e raundit të parë për zgjedhjet për kryetar komune më 20 nëntor. Rezultatet për votimin me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe me postë, iu shtuan rezultateve për komuna pa kurrfarë informate se sa ishin refuzuar (si rezultat i mosplotësimi të kushteve) apo sa ishin të vlefshme apo të pavlefshme, apo sa vota të pranuar ishin për secilin kandidat. Kjo çoi në mungesë të llogaridhënies në lidhje me përfshirjen e atyre fletëvotimeve. Më 2 dhjetor, KQZ-ja shpalli rezultatet për zgjedhjet për kuvend komunal, për të gjitha komunat përveç Zveçanit - kësaj radhe rezultatet përfshinin të dhënat e hollësishme për votat me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe me postë për çdo komunë.

Pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve për kryetarë komune dhe pas vendimeve rreth ankesave nga PZAP-ja, QNR-ja rinumëroi fletëvotimet nga 12 vendvotime nga komuna e Klinës, kurse pas shpalljes së rezultateve për kuvend komunal, u rinumëruan votat nga 71 vendvotime në 13 komuna.

Një çështje e përgjithshme shqetësimi pas shpalljes së rezultateve ishte numri shumë i lartë i votave të pavlefshme - 10% e të gjitha votave për zgjedhjet për kuvend komunal. Përderisa shumica e votave të pavlefshme mund t'i atribuohet faktit se votuesit nuk e kuptonin si të plotësohet fletëvotimi, shumë vota gjithashtu u shpallën të pavlefshme nga komisionet e vendvotimeve që ishin të trajnuar dobët, gjë që çoi në heqjen e të drejtës së votës shumë votuesve. Ka mundësi që disa votues të kenë hedhur votën e protestës duke zhvleftësuar votën e tyre nëse konstatonin se asnjë opsion nuk ishte i pranueshëm. KQZ-ja po planifikon analizimin e votave të pavlefshme, të identifikojë arsyet dhe të adresojë problemin para zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme.

Përderisa organizimi teknik i QNR-së ishte mbresëlënëse, tabelimi i rezultateve shkoi ngadalë, kurse transparencja e këtij procesi ishte paksa e kufizuar. Edhe pse vëzhguesit kishin qasje në të gjitha fazat e tabelimit, shkalla, kompleksiteti dhe kohëzgjatja e këtij operacioni e vështirësoi punën e vëzhgimit, përderisa kishte informata të kufizuara në lidhje me saktësinë e materialeve zgjedhore si dhe rezultateve të tabeluara. Shumë palë të interesit, përfshirë shumicën e subjekteve politike, shprehën pakënaqësinë me shpalljen e vonuar të rezultateve të raundit të parë, si dhe shprehën besim të kufizuar në punën e QNR-së dhe transparencën e saj.

## **XVI. REKOMANDIMET**

#	Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
	<b>Korniza ligjore</b>				
	Aspektet kryesore të procesit zgjedhor duhet të specifikohen në ligj e jo në rregullore me qëllim të rritjes së sigurisë ligjore dhe besimit në procesin zgjedhor	<p>(a) Të qartësohen aktivitetet e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve në LZP, përfshirë numërimin, tabelimin dhe certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve</p> <p>(b) Të qartësohet procedura për anulim të zgjedhjeve dhe përsëritjen e votimit</p> <p>(c) Të qartësohen përgjegjësitë e KQZ-së në lidhje me trajnimin e KKZ-ve dhe stafit të vendvotimeve</p> <p>(d) Të detajohen rregullat në lidhje me organizimin e ngjarjeve politike në ligj, e jo në rregulloren e KQZ-së</p>	Të ndryshohet LZP me qëllim të inkorporimit të rregulloreve të KQZ-së që mbulojnë këtë çështje	Kuvendi i Kosovës	Stabiliteti i rregullave  Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut, Këshilli i Evropës, Kapitulli 2
	E drejta për votë nuk i mohohet askujt që plotëson kriteret për të qenë shtetas i Kosovës (edhe nëse zyrtarisht nuk është)	Të qartësohen kriteret në LZP në lidhje me të drejtën për votë	Të ndryshohet LZHP	Kuvendi i Kosovës  KQZ	E drejta për votë KNDPCP , Neni 25 (b)
	Të përmirësohet saktësia e listës së votuesve	Të lejohet kohë e mjaftueshme për botim, rishikim, kundërshtim, konfirmim dhe miratim të listës së votuesve	Respektimi i afateve ligjore për botim të listës së votuesve	KQZ në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil	E drejta për votë dhe për mjete juridike  KNDPCP neni 25(b)  KEDNJ neni 13

					KNDCP neni 2 DUDNJ, neni 8
	<b>Administrimi i zgjedhjeve</b>				
	Të përmirësohet efikasiteti në administrimin e zgjedhjeve	Duhet të shqyrtohet mundësia për decentralizim të administrimit të zgjedhjeve për zgjedhjet komunale duke i dhënë më shumë përgjegjësi KKZ-ve, në veçanti në lidhje me emërimin e KVV-ve.	Ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit zgjedhor	Kuvendi i Kosovës, KZQ	Përforcimi i vetëqeverisjes lokale Praktika e mirë
	Të përmirësohet transparenca dhe efikasiteti në procesin e tabelimit të rezultateve	Tabelimi i rezultateve në zgjedhjet lokale mund të bëhet nën përgjegjësinë e KKZ-ve, në qendrat komunale për tabelimin e rezultateve	Ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit zgjedhor	Kuvendi i Kosovës, KZQ	Përforcimi i vetëqeverisjes lokale Praktika e mirë
	Të përmirësohet transparenca dhe efikasiteti në procesin e tabelimit të rezultateve	KQZ duhet të publikojë rezultatet e zgjedhjeve me hollësi të plota për vendvotim, përfshirë rezultatet e hollësishme të të gjitha fletëvotimeve me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe me postë, ku vëzhguesit duhet të pranojnë kopjet e formularëve me rezultate	Ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit zgjedhor	Kuvendi i Kosovës, KZQ	Të gjitha palët në zgjedhje duhet të kenë qasje në të gjithë regjistrat me tabelime të rezultateve  Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut, Këshilli i Evropës, I. 3.2.xii
	Të gjithë votuesve me të drejtë vote duhet t'i jepet kjo e drejtë	Procesi i votimit jashtë Kosovës duhet të jetë më i lehtë për votues. Rregullorja e KQZ-së për votim jashtë Kosovës duhet të përfshijë kritere të qarta që nuk janë të tepruara për regjistrim të	Ndryshimi i rregulloreve të KQZ-së	KQZ	E drejta universale dhe e barabartë  KNDCP , Neni 25 (b)



		votuesve, si dhe procedura më të lehta të votimit pa kërkesën që votuesit të dërgojnë me postë kopjen e letërnjoftimit me fletëvotim. Verifikimi i zarfeve me fletëvotime nga KQZ-ja duhet të bëhet më transparente			
	Të njoftohen votuesit drejtë rreth procedurave të votimit	Votuesit duhet të njoftohen me kohë, përmes medieve, rreth dokumenteve të pranueshme për identifikim të votuesve dhe për procedurat për votim jashtë Kosovës, në të gjitha gjuhët zyrtare	Ndryshimi i rregulloreve të KQZ-së	KQZ	Edukimi i votuesve, informimi publik rreth zgjedhjeve  KNDCP, Komete të përgjithshme 25, paragrafi 11
	Të gjithë votuesve me të drejtë vote duhet tu jepet kjo e drejtë	Puna në edukim të votuesve duhet të intensifikohet, në veçanti në adresimin e metodave të pranueshme për shënimin e fletëvotimeve	Përmirësimi i edukimit të votuesve	KQZ	Edukimi i votuesit, informimi publik rreth zgjedhjeve KNDCP, Komete të përgjithshme 25, paragrafi 11
	<b>Listat e votuesve</b>				
	Të përmirësohet saktësia e listave të votuesve	Duhet të punohet drejtë përmirësimit të saktësisë së listave të votuesve përmes adresimit të dobësive në sistemin e regjistrimit civil, në veçanti prania e personave të vdekur dhe gabimet tjera në regjistrim	Përditësimi dhe pastrimi i regjistrit civil	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Regjistrimi efektiv i votuesve, regjistri i votuesve duhet të përditësohet rregullisht  Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut, Këshilli i Evropës, 1.2. ii
	<b>Fushata</b>				

	Zbatimi efektiv i rregullave dhe transparencës financiare të fushatës në lidhje me shpenzimet dhe donacionet e subjekteve politike	KQZ-së duhet dhënë resurse dhe staf të mjaftueshëm për të mbikëqyrur zbatimin e rregullave rreth financimit të fushatës. Nga auditorët e emëruar duhet të kërkohet që të kontrollojnë regjistrat e dorëzuar të subjekteve politike nëse janë plotësuar drejtë	Të shtohen resurset e Zyrës së KQZ-së për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike	Kuvendi i Kosovës, KZQ	Zbatimi i rregullave financiare të fushatës në legjislacionin e Kosovës
	<b>Mediat</b>				
	Mjeti juridik efektiv	Të sigurohen mjete efektive juridike për ankuesit, të shqyrtohet mundësia për të ndryshuar legjislacionin ashtu që roli dhe kompetencat e KPM-së gjatë fushatës zgjedhore të rregullohen më në hollësi. Duhet të mbahen takime të rregullta për të shqyrtuar ankesat e pranuar dhe dënimet e shqiptuara para ditës së votimit	Ndryshimi i Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave	Kuvendi i Kosovës	Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut, Këshilli i Evropës, 19 i Raportit Shpjegues
	Transparenca	Me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe besimit publik, legjislacioni ekzistues duhet të përcaktojë seanca të hapura dhe publike të KPM-së	Zbatimi i Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave	Komisioni i Pavarur për Media	Ligji për Komisionin e Pavarur për Media, neni 7.4
	<b>Çështja gjinore</b>				

	Shtimi i pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe në procesin zgjedhor.	Çdo gjini duhet të ketë së paku 30% të përfaqësimit në organet e administrimit të zgjedhjeve	Të ndryshohet LZP dhe LZL	Kuvendi i Kosovës, KZQ	Mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozita të pabarabarta  KEDKG, neni 3
	Të sigurohet se masat e dizajnuara për të avancuar pjesëmarrjen e grave në jetën publike nuk bien ndesh me barazinë e votës	Kthimi në listat e mbyllura ku votuesit nuk zgjedhin kandidatët individual, apo nëse mbahen listat e hapura, aplikimi i kuotës gjinore vetëm në radhitjen e kandidatëve në listë e jo tek rezultatet	Ndryshimi i Kushtetutës dhe/ose LZP	Kuvendi i Kosovës	Barazia e votës  DUDNJ, neni 21
	<b>Kontestet zgjedhore</b>				
	T'i mundësohet ankuesit kohë e mjaftueshme për të përgatitur ankesën dhe për të dorëzuar provat, dhe PZAP-së për të shqyrtuar provat para nxjerrjes së vendimit	Të zgjatet periudha për parashtrim të ankesës në 48 orë dhe periudha për PZAP-në për të vendosur në 4 ditë	Të ndryshohet LZP	Kuvendi i Kosovës	Të drejta për mjete efektive juridike  KEDNJ neni 13 KNDCP neni 2 DUDNJ, neni 8
	T'i jepet mundësia ankuesit që të dorëzojë prova, si dhe të prezantojë rastin	Të garantohet e drejta për dëgjim të ankesave	Të ndryshohet LZP	Kuvendi i Kosovës, PZAP	E drejta për gjykim të drejtë  KEDNJ, neni 6 KNDCP, neni 14

	Të shtohet efikasiteti i gjithëmbarshtëm i sistemit për trajtim të kontesteve zgjedhore	Të përforcohen kapacitetet e Sekretariatit të PZAP-së me qëllim të përmirësimit të punës ligjore të PZAP-së në përgatitjen e vendimeve	T'i sigurohet PZAP-së më shumë buxhet Zyrtarët ligjor të PZAP-së të trajnohen Të krijohet baza e të dhënave të zyrtarëve ligjor	Kuvendi i Kosovës Sekretariati i PZAP-së	E drejta për gjykim të drejtë KNDCP, neni 14 DUDNJ, neni 10 KEDNJ, neni 6
	Të shtohet transparenca e procesit të ankesave dhe parashtrësive	PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të publikojnë ankesat dhe parashtrësit, si dhe vendimet, në të gjitha gjuhët zyrtare, në faqet e tyre në internet, dhe me kohë	Të ndryshohet Ligji për gjykatat	Kuvendi i Kosovës, PZAP dhe Gjykata Supreme	Transparenca
	Procesi i ankesave rreth shkeljeve zgjedhore t'i afrohet votuesve dhe të zbuten pengesat në kapacitetin e KZAP	(a) Të bëhet PZAP pjesë e Gjyqësorit të Kosovës.  (b) Të shqyrtohet mundësia e decentralizimit të procesit të ankesave, ashtu që t'i jepet përgjegjësi Gjykatave Themelore që të vendosin në shkallë të parë, kurse PZAP të jetë organ apeli	Të ndryshohet Ligji për gjykatat Të ndryshohet LZP	Kuvendi i Kosovës	Të drejtat për mjete efektive juridike KEDNJ neni 13 KNDCP neni 2 DUDNJ, neni 8

Legjenda e instrumenteve rajonal, ndërkombëtare dhe dokumentacionit të zbatueshëm teknik dhe informativ		
	Referencat dhe niveli i përkushtimit të Kosovës	
<b>A</b>	Kodi i Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore. Udhëzime dhe Raport sqarues, miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e 52-të të tij, 18-19 tetor 2002.	
<b>B</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948	<b>DUDNJ</b>
<b>C</b>	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e ndryshuar me protokollin e saj Nr. 14, 1 qershor 2010	<b>KEDNJ</b>
<b>D</b>	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj, 23 mars 1976	<b>KNDKP</b>
<b>E</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimi kundër Grave, 3 shtator 1981	<b>KEDKG</b>

<b>Shtojca 1 – Rezultatet e zgjedhjeve pwr kryetar [të komunës]</b>		
<b>Nr</b>	<b>Komuna</b>	<b>Zgjedhjet 2013</b>
1	Deçan	AAK
2	Gjakovë	AKR
3	Glllogoc	PDK
4	Gjilan	LDK
5	Dragash	PDK
6	Istog	LDK
7	Kaçanik	PDK
8	Klinë	PDK
9	Fushë Kosovë	LDK
10	Kamenicë	PDK
11	Mitrovica Jugore	AKR
12	Leposaviq	G.I. Srpska
13	Lipjan	LDK
14	Novobërdë	G.I. Srpska
15	Obiliq	AAK
16	Rahovec	PDK
17	Pejë	LDK
18	Podujevë	LDK
19	Prishtinë	LVV
20	Prizren	PDK
21	Skenderaj	PDK
22	Shtime	PDK
23	Shtërpcë	SLS
24	Suharekë	LDK

25	Ferizaj	LDK
26	Viti	LDK
27	Vushtrri	PDK
28	Zubin Potok	G.I. Srpska
29	Zveçan	G.I. Srpska
30	Malishevë	Iniciativa Qytetare për Malishevën (IQM)
31	Hani i Elezit	[Kandidati] i pavarur
32	Mamushë	Partia Turke e Drejtësisë në Kosovë (KTAP)
33	Junik	AAK
34	Klllokot	G.I. Srpska
35	Graçanicë	G.I. Srpska
36	Ranillug	G.I. Srpska
37	Partesh	G.I. Srpska
38	Mitrovicë Veriore	G.I. Srpska

**Shtojca 2 – Rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë [të komunës]**

<b>Subjekti politik</b>	<b>Nr. i komunave të fituara</b>
PDK	10
LDK	9
AAK	3
AKR	2
LVV	1
G.I. Srpska	9
SLS	1
Iniciativa Qytetare për Malishevën (IQM)	1
I pavarur	1
Partia Turke e Drejtësisë në Kosovë (KTAP)	1





<b>Shtojca 3 – Rezultatet për asamblētë komunale (Subjektet politike me më së shumti vota)</b>			
	<b>Subjekti politik</b>	<b>Votat</b>	<b>Ulëset</b>
	PDK	202301	259
	LDK	191122	224
	AAK-LDD	104536	132
	LVV	60436	69
	AKR	36112	41
	G.I. Srpska	21074	72
	Partia e Drejtësisë (PD)	14863	23
	Bashkimi Demokratik (BD)	14104	5
	Iniciativa Qytetare për Malishevën (IQM)	7806	11
	SLS	6842	26

### **Përsëritja e zgjedhjeve në Mitrovicë Veriore, 23 shkurt 2014**

Në janar, kryetari i zgjedhur i Mitrovicës Veriore refuzoi që të jap betimin brenda afatit ligjor. Si rrjedhojë, në këtë komunë më 23 shkurt u përsëritën zgjedhjet për kryetar të komunës.

Në këtë garë morën pjesë katër kandidatë, dy serbë dhe dy shqiptarë të Kosovës. Fushata ishte e profilit të ulët. Debati nuk u fokusua në çështjet që kishin të bënin me komunën, por ishin të preokupuara me arrestimin e njërit prej kandidatëve me akuza për krime lufte, si dhe me shqetësimet rreth pasaktësive dhe mangësive në listat e votuesve të cilat ishin azhurnuar kohëve të fundit. Në lista ishin të përfshirë rreth 500 shqiptarë më shumë se në zgjedhjet komunale të mbajtura në vitin 2013.

Zgjedhjet u mbajtën në mënyrë të qetë dhe pa incidente. Prania e konsiderueshme e Policisë së Kosovës dhe e forcave ndërkombëtare garantuan sigurinë. Përbërja e organeve lokale të zgjedhjeve, KKZ-ve dhe KKV-ve, në masë të madhe pasqyroi strukturën gjinore dhe etnike në komunë. Ata i kryen detyrat e tyre në mënyrë efikase me ndihmën e stafit të OSBE-së. Sikurse gjatë fushatës, edhe në ditën e zgjedhjeve prania e simboleve shtetërore të Kosovës në materialet zgjedhore nuk u duk se shkaktonte ndonjë problem. MBEVZ vërejti një respektim të plotë të së drejtës për votim universal, individual dhe të fshehtë dhe kishte një respektim të përgjithshëm të ligjeve dhe procedurave të zgjedhjeve.

Dalja në zgjedhje ishte e krahasueshme me atë të rundit të dytë. Tre orë pas mbylljes së vendvotimeve, KQZ-ja shpalli rezultatet preliminare duke i dhënë fitoren kandidatit të G.I. Srpska me një shumicë absolute, që nënkuptonte se nuk do ketë nevojë për rund të dytë.

PZAP nuk mori asnjë ankesë për fushatën e as për votim ose numërim. Nuk pati asnjë arrestim ose hapje të ndonjë rasti për vepra që lidhen me zgjedhjet.